

levizjafol.org/publikimet

FOL

PËRTEJ NUMRAVE

Performanca e
Prokurorive dhe Gjykatave
në luftën kundërkorrupsion
për vitin 2017

Maj 2018

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



PËRTEJ NUMRAVE

Performanca e
Prokurorive dhe Gjykatave
në luftën kundërkorrupsion
për vitin 2017

Maj 2018

Të drejtat e autorit © 2018. Lëvizja FOL.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përveç për citate të shkurtra për qëllime të kritikës dhe shqyrtimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sistem arkivimi, ose të transmetohet në çfarëdo forme ose mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të FOL.

Përgatitur nga: Jeton Zulfaj

Në bashkëpunim me: Nora Bajrami

Kontribut të veçantë: Gresa Smolica, Qendrim Bytyqi, Yllka Buzhala

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) - i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Lëvizjes FOL dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

Përmbajtja

Lista e Akronimeve	8
Mirënjohje	9
Përmbledhje Ekzekutive	10
Informata për projektin	11
Gjykatat	11
Prokuroria	11
Vizitat në gjykata dhe prokurori	12
Ligjëratat	12
Strategjia kundërkorrupsion	12

PERFORMANCA E PROKURORIVE NË LUFTËN KUNDËRKORRUPSION PËR VITIN 2017

Hyrje	17
Metodologjia	20
Fluksi i Lëndëve	21
Norma e zgjidhjes së Lëndëve	21
Norma e qarkullimit të lëndëve	22
Trendi	22
Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve	23
Indeksi i lëndëve të grumbulluara	23
Mbledhja e të dhënave	23
Prokuroritë Themelore – të dhëna për të gjitha prokuroritë	24
Analiza e Numrave	25
Niveli qendror	27
Fluksi i lëndëve	27
Norma e zgjidhjes së lëndëve (CR)	28
Norma e qarkullimit të lëndëve	29
Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve	30
Trendi i nivelizimit të lëndëve bazuar në performancën e vitit 2017	31
Indeksi i lëndëve të grumbulluara	31
Niveli Rajonal	33
Fluksi i lëndëve për prokuroritë themelore - Kapitulli XXXIV i kodit penal të Kosovës	33
Norma e zgjidhjes së lëndëve (për persona) për shtatë prokuroritë themelore si dhe për prokurorinë speciale	34
Trendi i zgjidhjes së lëndëve (për persona) bazuar në statistikat e vitit 2017 për prokuroritë themelore dhe atë speciale	35
Norma e qarkullimit të lëndëve (për persona) bazuar në statistikat e vitit 2017 për prokuroritë themelore dhe atë speciale	36
Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve për shtatë Prokuroritë Themelore si dhe për Prokurorinë Speciale	37
Indeksi i lëndëve të grumbulluara për shtatë Prokuroritë Themelore si dhe për Prokurorinë Speciale (për persona)	38

PERFORMANCA E GJYKATAVE NË LUFTËN KUNDËRKORRUPSION PËR VITIN 2017

Hyrje	43
Metodologjia	47
Fluksi i Lëndëve	48
Norma e zgjidhjes së Lëndëve	48
Norma e qarkullimit të lëndëve	49
Trendi	49
Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve	50
Indeksi i lëndëve të grumbulluara	50
Mbledhja e të dhënave	52
Gjykatat Themelore – të dhëna për të gjitha gjykatat	52
Analiza e Numrave	54
Niveli qendror	56
Fluksi i lëndëve	56
Norma e zgjidhjes së lëndëve	57
Norma e qarkullimit të lëndëve	58
Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve	59
Trendi i nivelizimit të lëndëve bazuar në performancën e vitit 2017	59
Indeksi i lëndëve të grumbulluara	60
Niveli Rajonal	62
Fluksi i lëndëve për gjykatat themelore - Kapitulli XXXIV i kodit penal të Kosovës	62
Norma e zgjidhjes së lëndëve për shtatë gjykatat themelore	63
Trendi i zgjidhjes së lëndëve bazuar në statistikat e vitit 2017 për shtatë gjykatat themelore	65
Norma e qarkullimit të lëndëve për shtatë gjykatat themelore	66
Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve për shtatë gjykatat themelore	67
Indeksi i lëndëve të grumbulluara për shtatë gjykatat themelore	68
Gjykatat Themelore / Statistikat antikorruption për persona - 2017	70
Përfundim	71
Biblografia	73
Shtojca I. Statistika krahasuese për prokuroritë 2016 - 2017	75
Niveli Qendror / Fluksi i Lëndëve	75
Norma e zgjidhjes së lëndëve	76
Norma e qarkullimit të lëndëve	76
Trendi i zgjidhjes së lëndëve	76
Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve në ditë	76
Indeksi i lëndëve të grumbulluara	76
Fluksi i lëndëve për periudhën 2016-2017 në të gjitha prokuroritë themelore dhe atë speciale	77
Norma e zgjidhjes së lëndëve	78
Trendi i zgjidhjes së lëndëve	78
Norma e qarkullimit të lëndëve	79
Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve	79
Indeksi i lëndëve të grumbulluara	80

Shtojca II. Statistika krahasuese për gjykatat 2016 - 2017	81
Niveli Qendror / Fluksi i Lendeve	81
Norma e zgjidhjes së lëndëve	82
Norma e qarkullimit të lëndëve	82
Trendi i zgjidhjes së lëndëve.....	82
Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve në ditë	82
Indeksi i lëndëve të grumbulluara	82
Fluksi i lëndëve për periudhën 2016-2017 në të gjitha gjykatat themelore.....	83
Norma e zgjidhjes së lëndëve	84
Trendi i zgjidhjes së lëndëve.....	84
Norma e qarkullimit të lëndëve	85
Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve	85
Indeksi i lëndëve të grumbulluara	86

Lista e Akronimeve

CEPEJ	Komisioni Evropian për Matjen e Efikasitetit të Drejtësisë
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
KE	Komisioni Evropian

Mirënjohje

Ky raport nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen dhe bashkëpunimin e ngushtë të zyrave për statistika në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK). FOL falënderon z. Besnik Ramosaj dhe Znj. Iliriana Paqarizi për bashkëpunim të ngushtë në ndarjen e informatave të nevojshme për realizimin e kësaj matje. FOL falënderon të gjithë kryetarët e gjykatave themelore dhe kryeprokurorët e prokurorive themelore për bashkëpunim të ngushtë me Lëvizjen FOL gjatë këtyre 21 muajve të monitorimit të punës së gjykatave.

Përmbledhje Ekzekutive

Në një shtet demokratik nën sundimin e ligjit, siç është Kosova, duhet të ketë një sitem të pavarur dhe funksional ligjor. Shkon pa u thënë, se gjyqësori (gjykatat dhe prokuroritë), janë shtylla kryesore në një shoqëri demokratike.

Për të arritur një shtet demokratik dhe funksional kërkohet një gjyqësor i pavarur, profesional me integritet, i pakorruptueshëm si dhe efektiv.

Prokuroria ka barrën kryesore në hetimin e korrupsionit në çdo nivel, posaçërisht atë të nivelit të lartë, që mbetet shqetësimi kryesor i shoqërisë civile dhe i bashkësisë ndërkombëtare. Më shumë se dy të tretat e qytetarëve nuk besojnë në prokurori dhe gjykata, çka duhet të jetë alarm për Këshillin Gjyqësor dhe atë Prokurorial të Kosovës.

Në vitin 2017 prokuroritë kanë pasur në trajtim për korrupsion 1799 persona ndërkaq 1204 persona kanë pritur drejtësi para gjykatave për po të njëjtat vepra penale. Në një shtet me 1.8 milion banorë këto shifra janë alarmante dhe duhet të lexohen jo vetëm nga gjykatat dhe prokuroritë por nga qeveria dhe gjithë shoqëria. Mbi 90% e personave të akuzuar për korrupsion janë zyrtarë publikë, shifër kjo e cila flet edhe për natyrën e korrupsionit dhe për faktin se sa e korruptuar është e gjithë administrata shtetërore.

Në këtë raport Lëvizja FOL është munduar që të pasqyrojë performancën e gjykatave dhe prokurorisë në luftën kundërkorrupsion. Edhe pse raporti tregon për një performancë të mirë në numra të prokurorisë dhe gjykatave për vitin 2017, gjendja vazhdon të jetë e rëndë. Numri i lëndëve të bartura vazhdon të jetë i lartë, kurse fluksi i lëndëve të reja të korrupsionit vazhdon të mbetet i njëjtë duke treguar që korrupsioni, e sidomos keqpërdorimi i pozitës dhe autoritetit zyrtar vazhdon të jetë prezent. I takon Këshillit Gjyqësor dhe atij Prokurorial që të kthejnë besimin tek qytetarët duke rritë performancën, integritetin dhe efektivitetin e gjykatave dhe prokurorive.

Informata për projektin

Në Shtator 2016, Lëvizja FOL ka marrë mbështetje në formë të grantit institucional nga programi ‘Promovimi i Shoqërisë Demokratike’ (DSP) i mbështetur nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO –K), Ministria e Punëve të Jashtme të Danimarkës (DANIDA) dhe zbatuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Granti nga DSP ka synuar të mbështesë Lëvizjen FOL në ngritjen e qëndrueshmërisë për monitorim të vazhdueshëm të punës së gjyqësorit në luftën kundërkorrupsion si dhe në përmirësimin e legjislacionit në prokurimin publik.

Përmes këtij granti, Lëvizja FOL për 21 muaj ka monitoruar punën e prokurorisë dhe gjykatave si dhe ka matur performancën e tyre në luftën kundër korrupsionit.

Gjykatat

Projekti është i fokusuar në gjykata dhe në prokurori themelore. Gjykatat të cilat janë pjesë e monitorimit në këtë projekt janë gjykatat themelore në Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjiilan. Projekti do të masë performancën e gjykatave në fushën e kundërkorrupsionit përmes metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) dhe disa formulave të zhvilluara nga Lëvizja FOL.

Prokuroria

Tek prokuroria, projekti do të monitorojë dhe masë performancën bazuar në statistikën e vetë prokurorive. Prokuroritë themelore në Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjiilan do të jenë pjesë e matjes së performancës dhe monitorimit.

Vizitat në gjykata dhe prokurori

Për 21 muaj janë vizituar gjashtë gjykata dhe gjashtë prokurori themelore. Vizitat janë realizuar me kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët e prokurorive themelore. E pamundur ka qenë të kontaktojmë me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore të Prishtinës, të cilën prokurori nuk kemi arritë ta vizitojmë dhe të zhvillojmë takime. Po ashtu vizita nuk është realizuar as në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.

Pothuajse të gjitha gjykatat themelore kanë ambiente të mira të punës. Gjykatat themelore në Gjilan, Prishtinë dhe Ferizaj veq kanë kaluar në objekte të reja, të cilat i plotësojnë të gjitha kushtet për punë të gjyqtarëve, për mbajtjen e seancave të rregullta. Po ashtu, Prokuroria Themelore e Ferizajt, Gjilanit dhe e Pejës janë bartur në objekte të reja. Vlen të theksohet objekti i Prokurorisë Themelore të Gjakovës si dhe i Mitrovicës, të cilat nuk ofrojnë ambient të përshtatshëm pune, pasi që ato dy objekte janë shtëpi të adaptuara në Prokurori Themelore.

Ligjëratat

Janë realizuar 6 ligjërata me 10 prokurorë dhe gjyqtarë si dhe persona që punojnë në fushën e drejtësisë. Ligjëratat janë mbajtur në Qendrën Kundërkorrupsion të Lëvizjes FOL si dhe në Universitete Publike dhe Private me studentë të fakultetit juridik. Rreth 250 studentë kanë ndjekur ligjëratat me gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët kanë ndarë jo vetëm njohuritë por edhe përvojën e tyre në luftimin e korrupsionit duke kontribuar kështu në rritjen e transparencës rreth punës së gjyqësorit dhe prokurorisë.

Strategjia kundërkorrupsion

Në kuadër të këtij projekti është monitoruar edhe zbatimi i Strategjisë Kundër Korrupsion 2013-2017 në sektorin e zbatimit të ligjit, Prokurorisë dhe Gjyqësorit. Më konkretisht janë monitoruar dy objektiva të kësaj strategjie: *1) Rritja e nivelit të efikasitetit të institucioneve zbatuese të ligjit në prokurori edhe gjykata, për të parandaluar, hetuar dhe gjykuar rastet korruptive dhe 2) Rritja e profesionalizmit, pavarësisë dhe integritetit të institucioneve të zbatimit të ligjit, prokurorisë dhe gjykatave.*

Në lidhje me këto objektiva, janë dërguar pyetje në Këshillin Gjyqësor për të kuptuar se sa është realizuar Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Kundër Korrupsion 2013-2017. Në përgjigjen që kemi marrë nga KGJK del se Këshilli ka formuar një Komision që në mënyrë permanente nga fillimi i vitit 2016 bën monitorimin e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit dhe përgatit raporte për çdo muaj për të treguar progresin dhe sfidat e gjykatave në trajtimin e këtyre lëndëve. Gjatë periudhës 2013-2017 gjykatat kanë zgjidhur gjithsej 1076 lëndë të korrupsionit. KGJK ka dështuar të specializoj gjyqtarë që të merren ekskluzivisht me rastet e korrupsionit siç ishte parashikuar me strategjinë antikorrupsion, duke bërë që këto lëndë ende të zgjidhen nga gjyqtarët e Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatave Themelore dhe Gjykatës së Apelit. Këta gjyqtarë ndjekin trajnime të specializuara nga Akademia e Drejtësisë.

Sa i përket vlerësimit të performancës së gjyqtarëve, komisioni për vlerësimin e performancës ka vlerësuar 1/3 e gjyqtarëve me mandat të përhershëm të përzgjedhur sipas shortit, dhe nga ky vlerësim nuk është suspenduar asnjë gjyqtar.

Performanca e **Prokurorive** në
luftën kundërkorrupsion për vitin
2017

Hyrje

Në vitin 2016 Prokuroria kishte një performancë pozitive të zgjidhjes së lëndëve me një normë prej 130%. Një normë e tillë vinte si rezultat i zgjidhjes së më shumë lëndëve se sa që pranoreshin në sistem.

Në vitin 2017 prokuroria ka treguar prapë një performancë pozitive në përballimin e fluksit të lëndëve duke zgjidhur më shumë lëndë se sa që ka pranuar.

Për dallim nga gjykatat, ku matja bëhet me lëndë, në prokurori matjen e bëjmë me persona. Ky ndryshim është i rëndësishëm pasi prokuroria investon më shumë kohë në persona gjatë fazës së hetimeve nga pranimi i kallëzimit penal.

Sikurse në vitin 2016, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar mbetet lloji më i përhapur i korrupsionit edhe për vitin 2017 sipas të gjeturave të këtij raporti. Kushtëzimi i shërbimeve publike nga zyrtarë shtetëror për përfitime personale, keqpërdorimi i pozitës zyrtare për përfitim personal, ushtrimi i presionit dhe ndikimit nga pozita zyrtare, pasurimi i paligjshëm janë të gjitha vepra korruptive të cilat po e pengojnë sundimin e ligjit dhe po rrënojnë besimin në institucione publike.

Përceptioni i lartë i prezencës së korrupsionit tek institucionet publike dhe zyrtarët qeveritar, bënë që qytetarët të varin shpresat tek prokuroria dhe gjykatat si adresat e fundit për të gjetur drejtësi dhe për të ndëshkuar të korruptuarit. Janë fillimisht prokurorët e pavarur dhe profesionalë të cilët kanë guxim të hetojnë korrupsionin në cilindo nivel dhe pastaj gjyqtarët të cilët ndajnë drejtësinë dhe vendosin nëse ligji është i barabartë për të gjithë.

Përkundër performancës pozitive në trajtimin e fluksit të lëndëve të korrupsionit, prokuroria vazhdon të jetë ndër institucionet në të cilat qytetarët besojnë më së paku sipas pulsit publik i publikuar nga UNDP-ja. Në Tetor 2016, rreth 16% e qytetarëve shprehën kënaqshmëri me punën e prokurorisë (UNDP - Kosove, 2016, pp. 4,8), kurse në Tetor 2017 kënaqshmëria u

rrit me 17%, duke arritur në nivelin 33%¹

Prania e madhe e korrupsionit në shoqëri bën që të bie besimi në gjithë institucionet e shtetit, e në veçanti në ato të drejtësisë.

Komisioni Evropian në raportin e vendit për Kosovën për vitin 2018 ka raportuar se *“korrupsioni mbetet i përhapur në tërë vendin dhe mbetet çështje shqetësuese dhe se nevojiten përpjekje të përbashkëta për të trajtuar këtë problem në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe strategjike* (EU Commission, 2018)”.

Besimi i qytetarëve në prokurori sipas
“Pulsit Publik nga UNDP – Kosovo”

2016	2017
16%	33%

Duke pasur fuqinë e kushtëzimit në procesin integrues, BE-ja vendosi kriteret të qarta për procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën, ku ndër kriteret kryesore ishte dëshmia me numra (European Commission, 2016) nga prokuroria në hetimin e korrupsionit të nivelit të lartë. Kjo pati ndikim, pasi përpjekjet e prokurorisë për të performuar duken edhe në këtë raport.

Megjithatë sistemi i drejtësisë vuan vetë nga i njëjti sindrom, pra korrupsioni. Kjo është konfirmuar nga Komisioni Evropian i cili vëren se sistemi i drejtësisë është i prekur nga korrupsioni dhe ndikimi politik dhe ka mungesë të besimit të qytetarëve (European Commission, 2016). Të njëjtat shqetësime ndajnë edhe Departamenti Amerikan i Shtetit dhe organizatat tjera ndërkombëtare dhe vendore (Department of State, 2015).

Pavarësia dhe paanshmëria e prokurorisë është thelbësore për funksionimin e një shteti demokratik. Besimi i qytetarëve se ata nuk do të jenë subjekt i përndjekjes nga prokurorë të ndikuar nga politika dhe korrupsioni apo që ndjekin interesa të caktuara; besimi i bizneseve se ato nuk përndjeken nga prokurorët pa dëshmi të bazuara vetëm për të eliminuar konkurrencën e grupeve të lidhura me prokurorë; besimi i aktivistëve dhe politikanëve se ata nuk do të përndjeken nëse flasin hapur kundër pushtetit është jetik për zhvillimin e shoqërisë demokratike.

Nga skanimi i integritetit i realizuar nga Lëvizja FOL në Dhjetor 2017, del që prokurorët, edhe pse në masë të vogël, janë të ndikuar nga faktorë të jashtëm në nisjen e hetimeve, në mesin e tyre interesat financiare dhe mediat.

Rritja e besimit në institucione të drejtësisë është proces që vazhdimisht duhet të ndërtohet dhe përmirësohet.

Hapi i parë pa dyshim është rritja e kriterëve të shkëlqyeshmërisë që mundëson që prokurorët të jenë profesional dhe me integritet².

¹ http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/public-pulse-xiii/

² Lëvizja FOL në bashkëpunim me Qendrën për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (CILC) në Holandë dhe Institutin Demokratik të Kosovës (KDI) kanë realizuar gjatë vitit 2017 një skanim të integritetit për gjyqtarë dhe prokuror i cili është

Hapi i dytë është ngritja e përgjegjësisë dhe transparencës. Një numër i madh i aktakuzave hidhen çdo vit si të pabazuara nga gjykatat, kryesisht për shkak të mungesës së profesionalizmit por edhe të ndikimit të grupeve të interesit. KPK ka për detyrë që të shkëpusë lidhjet e prokurorëve me grupet e interesit duke monitoruar punën e prokurorëve dhe duke forcuar standardet e integritetit për prokurorë.

Transparenca nënkupton që aktakuzat e prokurorëve të jenë të hapura për publikun e gjerë, për studiuesit e ligjit, për avokatët, për mediat dhe shoqërinë civile.

Shërbimi prokurorial ende konsiderohet njëri ndër sektorët më sekret të shoqërisë. Statistikat janë të papërpunuara dhe të pakuptueshme dhe dekurajuese për ata që monitorojnë këtë sektor (European Commission, 2016).

Lëvizja FOL vazhdimisht punon për të rritur transparencën e institucioneve publike, duke përfshirë edhe prokurorinë. Publikimi i këtij raporti me statistika për punën dhe performancën e prokurorisë është një hap më tepër në këtë drejtim.

Ky raport hedh dritë jo vetëm për punën e prokurorisë në fushën e kundërkorrupsionit, që besojmë se do të i shërbejë vetë prokurorisë për t'u përmirësuar, por ai fton qytetarët që të njoftohen me punën e shërbimit prokurorial, duke ndikuar në rritjen e besimit dhe krijimin e një perceptimi më real.

Raporti tregon se prokuroria është duke u munduar që të japë kontributin e saj në luftën kundër korrupsionit përkundër mungesës së besimit në të.

Sikurse në raportin për gjykata, edhe raporti për prokuroritë është statistikor i bazuar në statistikat zyrtare të KPK-së.

Raporti bazohet vetëm në numra dhe si i tillë nuk mund të tregoj për cilësinë e punë së prokurorëve dhe prokurorive; nuk është në gjendje të tregoj nëse prokurorët kanë qenë të pavarur, profesionale dhe të pandikuar gjatë punës së tyre. Për të bërë një analizë të tillë do të duhej që të analizoheshin lëndë konkrete në tërësinë e tyre.

Ky raport është një përpjekje për të rritur transparencën në sektorin e drejtësisë dhe për të shtuar ndikimin në ngritjen e performancës së prokurorisë në luftimin e korrupsionit.

Pjesa e parë e raportit jep një hyrje të gjatë në të cilën jepen detaje të rëndësishme në lidhje me kuptimin e punës së prokurorisë në fushën kundërkorrupsion si dhe flet për rëndësinë e raportit.

Më pas prezantohet metodologjia e përdorur për hartimin e raportit dhe vazhdon me prezantimin e të gjeturave duke sjellë edhe statistika krahasuese në fund të raportit që mundëson të krahasohet performanca mes vitit 2016 dhe 2017.

Metodologjia

Duhet të theksojmë me fillim se matja e performancës së prokurorisë nuk është një punë e lehtë. Për dallim nga gjyqësori, puna e të cilit matet me lëndë, puna prokurorisë matet me persona. Kjo sepse prokuroria investon kohë të gjatë në përgatitjen e një lënde e cila mund të përfshijë një e më shumë persona.

Natyrisht hetimi nuk është i njëjtë dhe ai ndryshon varësisht prej veprës penale për të cilën hetohet dhe sa kompleks është rasti. Të gjitha këto dhe shumë të tjera, ndikojnë në trajtimin e një rasti si dhe në kohëzgjatjen e tij deri në shëndrrimin në aktakuzë.

Siç u pa nga raporti për gjykatat, për matjen e performances së gjyqësorit Lëvizja FOL ka përdorur formulat e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) (CEPEJ, 2015). Vetë CEPEJ nuk ka bërë matjen e efikasitetit të shërbimit prokurorial³.

Megjithatë, pas analizës, FOL ka ardhë në përfundim se formulat nga CEPEJ për gjykatat janë të përdorshme edhe për matjen e efikasitetit të prokurorive mbi bazën e statistikave zyrtare.

Matja nuk përfshinë nuk përfshin të gjitha lëndët dhe llojet e veprave. Matja bëhet vetëm për një grup të veçantë të veprave penale, më saktësisht për kapitullin XXXIV të Kodit Penal të Kosovës – Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, nenet 422 – 437⁴.

Matja nuk tregon për cilësinë e lëndëve dhe cilësinë e punës së prokurorëve, shërbimit të administratës apo integritetin dhe profesionalizmin prokurorëve.

Fushat në të cilat FOL do të mas performancën e prokurorisë janë si në vazhdim: 1) Fluksi i

³ Lëvizja FOL ka kontaktuar me Adis Hodzic – këshilltar i lartë për statistika, sekretariati i lartë i Gjykatave dhe Prokurorisë, Këshilli i Bosnjes dhe Hercegovinës. Ekspert i BE-së. Përgjigja nga Hodzic është se kjo qështje është kërkuar që të hyjë në agjenden e GT-EVAL për diskutim por nuk ka kaluar dhe ka mbetur të diskutohet në takimin e radhës të CEPEJ. FOL nuk ka gjetur asnjë publikim nga CEPEJ për matjen e prokurorive.

⁴ Shiko tabelen 1: Kodi Penal i Kosovës. Kapitulli XXXIV – Korrupsioni Zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare

lëndëve, 2) norma e zgjidhjes së lëndëve, 3) norma e qarkullimit të lëndëve, 4) trendi i zgjidhje së lëndëve, 5) kohëzgjatja e trajtimit të lëndëve dhe 6) indeksi i lëndëve të grumbulluara.

Fluksi i Lëndëve

Fluksi i lëndëve është tregues i rendësishëm që tregon se me çfarë fluksi përballen prokuroritë dhe si menaxhojnë ato këtë fluks. Kjo përfshinë lëndë të reja, lëndë të zgjidhura dhe lëndë në pritje të zgjidhjes. Numri i lëndëve të reja nënkupton numrin e lëndëve që futen në sistem dhe që kërkojnë veprim nga prokurorët, numri i lëndëve të zgjidhura është përgjigja që jep sistemi i prokurorisë pra, numri i lëndëve që trajtohen. Lëndët që priten të trajtohen⁵ janë numri i lëndëve që mbeten për t'u zgjidhur nga prokuroria apo prokurori, në një kohë të caktuar dhe si të tilla janë lëndë që barten.

FORMULA. $LP=PS+I : PE=LP-R$

Shembull:

Njësia matëse:	Lëndë të pazgjidhura më 1 Janar 2017 (PS = lëndë në fillim të periudhës raportuese ⁶)	Lëndë të reja (I)	Lëndë në Punë (LP)	Lëndë të zgjidhura gjatë vitit kalendarik (R)	Lëndë të pazgjidhura më 31 Dhjetor 2017 (PE lëndë të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese)
Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	1424	826	2250	1073	1177

Norma e zgjidhjes së Lëndëve⁷

Është një indikator jashtëzakonisht i rendësishëm sepse mat raportin midis lëndëve të zgjidhura (R) dhe numrit të lëndëve të reja (I). Si i tillë, ky indikator tregon performancën e një prokurorie të shprehur në përqindje duke na lehtësuar kuptimin e nivelit të përkushtimit.

FORMULA. $\text{norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura në fund të periudhës raportuese}}{\text{lëndët e reja gjatë periudhës raportuese}} \times 100$

⁵ Trajtimi dhe zgjidhja mund të shërbejnë si fjalë që përmbushin njëra tjetrën. Për gjykata përdoret fjala 'zgjidh' kurse për prokurori 'trajton'. Kjo pasi lënda në prokurori nuk konsiderohet e zgjidhur pa një vendim të gjykatës.

⁶ Këtu e tutje, me periudhë raportuese nënkuptohet periudha brenda një viti kalendarik

⁷ Clearnace rate - në anglisht

Shembull:

Lëndët e zgjidhura në fund të periudhës raportuese (R)	1073
Lëndët e reja gjatë periudhës raportuese (I)	826
Norma e zgjidhjes së lëndëve	130%

Norma e qarkullimit të lëndëve

Norma e qarkullimit të lëndëve mat raportin mes numrit të lëndëve të zgjidhura dhe numrit të lëndëve të pazgjidhura. Ky raport e mat frekuencën me të cilën sistemi prokurorial ose prokuroria e zëvendëson numrin e lëndëve të reja. Formula përdorë numrin e lëndëve të zgjidhura në fund të periudhës raportuese dhe e pjesëton me numrin e lëndëve të pazgjidhura duke nxjerrë një normë të qarkullimit të lëndëve. Norma ideale e qarkullimit duhet të jetë 1⁸ që nënkupton se sistemi zgjidhë po aq lëndë sa pranon gjatë vitit.

FORMULA. $norma\ e\ qarkullimit\ të\ lëndëve = \frac{\text{numri i lëndëve të zgjidhura në fund të periudhës raportuese}}{\text{numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese}}$

Shembull:

Numri i lëndëve të zgjidhura në fund të periudhës raportuese	1073
Numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese	1177
Norma e qarkullimit të lëndëve	0.91

Trendi

Mat raportin mes lëndëve të trashëguara dhe numrit të lëndëve të zgjidhura minus lëndët e reja.

Trendi nuk është pjesë e formulës nga CEPEJ, kjo formulë është derivuar nga FOL duke marrë parasysh formulat tjera. Trendi në këtë raport nënkupton performancën e prokurorive në pastrimin e lëndëve të grumbulluara. Për të lehtësuar matjen e trendit në këtë raport, Trendi këtu llogaritet duke marrë si statike performancën e prokurorisë në vitin 2017.

FORMULA. $trendi = \frac{\text{Numri i lëndëve të bartura (LP)}}{\text{Numri i lëndëve të zgjidhura (R) - Numri i lëndëve të reja (I)}} - 1$

⁸ 1 (ose 100%). Shembull 100% është normë ideale e qarkullimit që nënkupton se sistemi ka zgjidhur po aq lëndë sa ka pranuar gjatë viti dhe nuk ka bartur asnjë lëndë për vitin e ardhshëm.

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve është tregues i cili mat kohën e përfundimit të lëndëve. Formula merr parasysh tërësinë e lëndëve për një periudhë të caktuar dhe bazuar në performancën e treguar në raportin e qarkullimit të lëndëve e kthen performancën për kryerjen e lëndëve në kohëzgjatje me ditë. Ky tregues është i rëndësishëm për të parë se sa kohë merr secila prokurori në trajtimin e lëndëve (per persona). Natyrisht matja nuk tregon për lëndët specifike pasi në realitet një lëndë mund të marrë më shumë kohë se sa një tjetër, por formula merr parasysh hyrjen dhe daljen e lëndëve në sistem bazuar në performancën e treguar. Kur një prokurori nuk ka lëndë të bartura, ajo trajton lëndët në kohë më të shkurtë duke bërë që drejtësia të mos vonojë.

FORMULA. $\text{Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve} = \frac{365}{\text{Raporti i qarkullimit të lëndëve}}$

Indeksi i lëndëve të grumbulluara

Është indikator i cili tregon performancën e prokurorive në përfundimin e lëndëve të grumbulluara. Numri i madh i lëndëve të grumbulluara ndikon direkt në performancën e prokurorive. Një vlerë e lartë e indeksit të lëndëve të grumbulluara tregon se duhet kohë më e gjatë për zgjidhjen e lëndëve. Sa më shumë lëndë që barten për vitin pasues, aq më shumë do të vonojë prokuroria në ngritjen e aktakuzave.

FORMULA. $\text{indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{\text{numri i lëndëve të bartura në fillim të periudhës raportuese}}{\text{Numri i lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese}}$

Performanca e gjykatave dhe prokurorive në këtë raport do të matet me këto formula dhe me këtë sistem të vlerësimit.

Mbledhja e të dhënave

Lëvizja FOL në vazhdimësi mbledh të dhënat⁹ në fushën e korrupsionit nga gjykatat dhe prokuroritë në baza tre mujore. Në vitin 2017 ka vazhduar mbledhja e të dhënave për grupin e veprave kundërkorrupsion nga gjykatat dhe prokuroritë themelore në baza tremujore dhe vjetore.

Në vazhdim janë të paraqitura grafikonet për të gjitha llojet e veprave penale nga grupi i veprave penale “Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, nenet 422 – 437, kapitulli XXXIV i Kodit Penal të Kosovës”.

⁹ Të dhënat janë siguruar përmes e-mailit nga zyra për statistika në Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK)

NENI	KATEGORIA
422	Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar
423	Keqpërdorimi i informatës zyrtare
424	Konflikti i interesit
425	Përvetësimi në detyrë
426	Mashtrimi në detyrë
427	Përdorimi i paautorizuar i pasurisë
428	Marrja e ryshfetit
429	Dhënia e ryshfetit
430	Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj
431	Ushtrimi i ndikimit

NENI	KATEGORIA
432	Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore
433	Zbulimi i fshehtësisë zyrtare
434	Falsifikimi i dokumentit zyrtar
435	Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme
436	Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor
437	Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare

Tabela 1: Kodi Penal i Kosovës. Kapitulli XXXIV – Korrupsioni Zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare

Prokuroritë Themelore – të dhëna për të gjitha prokuroritë

Gjatë fazës së mbledhjes së informatave dhe statistikave, Lëvizja FOL ka kërkuar informata të përgjithshme dhe specifike në luftën kundërkorrupsionit. Të dhënat e përgjithshme janë ato informata të cilat japin një pasqyrë të përgjithshme për punën e prokurorive të cilat janë të hapura për publik kurse specifike janë ato informata të cilat prokuroria i përdorë për prioritete të caktuara.

Në përgjithësi, zyra për statistika në Këshillin Prokurorial të Kosovës ka qenë bashkëpunuese dhe nuk kemi pasur pengesa në qasjen e informatave.

Në Tabelën 1 ne listuam të gjitha kategoritë e veprave penale në kuadër të kapitullit XXXIV, në vazhdim do të japim një pasqyrë të përgjithshme me të gjitha statistikatat nga të gjitha prokuroritë themelore me të dhëna për secilën kategori pastaj do të bëjmë analizën e numrave.

Analiza e Numrave

Është e lehtë të humbet interesimi për numrat nëse nuk zbërthejmë domethënien e tyre. FOL është munduar që numrat e mësipërm t'i zbërthejë duke përdorë një metodologji e cila i bënë më të kuptueshëm dhe të qasshëm për lexuesin dhe që mundëson të kuptojmë progresin në luftën kundërkorrupsion.

Qëllimi i këtij raporti nuk është në asnjë mënyrë që të zëvendësojë statistikën zyrtare të publikuar nga KPK, por ne synojmë që këta numra t'i bëjmë më të kuptueshëm për qytetarët. Në secilën prej tableave dhe formulave që prezantojmë mundohemi t'i përgjigjemi pyetjeve sikurse: Çka tregon tabela e mësipërme për performancën e prokurorive në fushën e korrupsionit? A kanë pasur prokuroritë një performancë të mirë? Sa kohë merr trajtimi i një lëndë? Cila prokurori ka performuar më mirë?

Ajo që vërejmë nga grafikonët e mësipërm është se prokuroritë në gjithë territorin e Kosovës kanë pasur një performancë të mirë në luftën kundërkorrupsion në kuptimin që ato kanë arritur të trajtojnë shumicën e lëndëve, në raport me numrin e lëndëve të pranuar.

Nga i gjithë grupi i veprave të korrupsionit, vepra penale e keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, është vepra që përsëritet më së shpeshti e që është indikacion edhe i llojit dhe nivelit të korrupsionit.

Korrupsioni zyrtar është korrupsioni i cili ushtrohet nga personi i autorizuar në një organ shtetëror, personi i zgjedhur ose i emëruar në një organ shtetëror, apo personi i cili ushtron detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj. (Kodi Penal, 2012).

Në vitin 2017, prokuroritë kanë pasur në punë 1799 lëndë (persona) në fushën e korrupsionit. Nga 1799 persona, prokuroritë kanë trajtuar 843 persona duke bartur për vitin pasues 956 lëndë për persona.

Edhe përkundër numrit të madh të lëndëve të trajtuara për vitin 2017 (843) dhe numrit të

përsonave për të cilët prokuroria ka marrë veprime të caktuara: ka hudhur kallezimin penal (334); ka pushu hetimin (189), megjithatë numri i aktakuzave (273), mbetet i vogël në krahasim me numrin e përgjithshëm personave nën hetim (1799).

Ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë se cilat janë arsyet që prokuroria ka hedhur poshtë kallëzimet penale për 334 persona pasi kjo kërkon qasje më të thellë në dosjet dhe informatat e prokurorive dhe prokurorëve, por në këta numra pa dyshim që përfshihet edhe parashkrimi i veprave penale, qështje kjo mjaftë shqetësuese.

Në prokuroritë fshehin mënyrat e zgjidhjes së disa lëndëve. Prokuroria, në statistikat zyrtare, nuk ka dërguar numrin e lëndëve të parashkruara.

Niveli qendror

Në këtë pjesë ne do të bëjmë analizimin e numrave përmes formulave të cilat tregojnë për performancën e prokurorive themelore në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit për vitin 2017.

Fluksi i lëndëve

Bazuar në metodën e CEPEJ, fluksi i lëndëve do të na tregojë se si qëndron raporti mes lëndëve të reja, lëndëve të zgjidhura dhe lëndëve në pritje. Siç u tha më lartë, numri i lëndëve të reja nënkupton numrin e lëndëve që hyjnë në sistem dhe që kërkojnë drejtësi; numri i lëndëve të zgjidhura është përgjigja që jep sistemi i drejtësisë, pra numri i lëndëve që zgjidhen. Lëndët që priten të zgjidhen ose lëndët e papërfunduara janë numri i lëndëve që mbeten për t'u zgjidhur nga gjykata në një kohë të caktuar dhe si të tilla janë lëndë që barten.

Edhe përkundër numrit të madh të lëndëve të trajtuara për vitin 2017 (843) dhe numrit të personave për të cilët prokuroria ka marrë veprime të caktuara: ka hudhur kallezimin penal (334); ka pushu hetimin (189), megjithatë numri i aktakuzave (273), mbetet i vogël në krahasim me numrin e përgjithshëm personave nën hetim (1799)

FORMULA. Formula: $LP=PS+I$; $PE=LP-R$

(**LP** = Lëndë në Punë. **PS** =Lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese. **I**=Lëndë të reja të hapura gjatë periudhës raportuese. **PE**=Lëndë të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese. **R**=Lëndë të zgjidhura gjatë vitit kalendarik).

të gjitha Prokuroritë themelore si dhe Prokuroria Speciale për persona Nivel kombëtar.	Njësia matëse: Lloji i veprës penale	Lëndë të pazgjidhura më 1 Janar 2017 (PS)	Lëndë të reja të hapura gjatë vitit kalendarik (I)	Lëndë në Punë (LP)	Lëndë të zgjidhura gjatë vitit kalendarik (R)	Lëndë të pazgjidhura (për persona) me 31 dhjetor 2017 (PE)
	Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, nenet 422 - 437	1177 ¹⁰	622 ¹¹	1799 ¹²	843	956

Tabela 2 Statistikat vjetore për prokuroritë themelore dhe atë speciale për vitin 2016 për veprat penale korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare.

$$(LP) 2250 = PS 1424 + (I) 826 \quad \text{ose} \quad (PE) 1177 = (LP) 2250 - (R) 1073$$

Siç vërejmë nga tabela e mësipërme, për të gjitha kategoritë në kuadër të kapitullit XXXIV të Kodit Penal të Kosovës në vitin 2017 janë bartur 1177 lëndë (persona) nga viti paraprak (2016). Janë pranuar 622 lëndë (persona) gjatë vitit kalendarik 2017, duke bërë që gatë vitit 2017 prokuroritë të trajtojnë 1799 lëndë (persona).

Në nivel qendror, krahasuar me vitin 2016 ka një rënie të lëndëve (per persona) të reja të korrupsionit për 204 persona më pak çka ka rezultuar me rënie edhe të numrit të lëndëve në punë. Në vitin 2016 prokuroritë kishin 2250 persona në trajtim (lëndë në punë), kurse në vitin 2017 ky numër ka rënë në 1799 persona, një diferencë prej 451 personave. Ky ndryshim ka ardh për shkak se ka rënie tek numri i lëndëve të reja të korrupsionit numrit të lëndëve të bartura.

Numri i lëndëve në punë (për persona) (LP) është rezultati në mes të lëndëve të trashëguara nga viti paraprak (PS) plus numri i lëndëve të reja të pranuar gjatë vitit kalendarik raportues (I). Ndërkaq lëndë të pazgjidhura (PE) është diferenca mes lëndëve në punë gjatë vitit kalendarik (LP) dhe lëndëve të zgjidhura gjatë vitit kalendarik (R).

Norma e zgjidhjes së lëndëve (CR)

$$\text{FORMULA (CEPEJ):} \quad \text{norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura në fund të periudhës raportuese}}{\text{lëndët e reja gjatë periudhës raportuese}} \times 100$$

$$\text{RRJEDHIMISHT:} \quad \text{norma e zgjidhjes së rasteve \%} = \frac{843}{622} \times 100 = 135\%$$

10 SQARIM: Më 31 Dhjetor, 2016 Këshilli Prokurorial raporton se në nivel qendror janë bartur 1248 persona per t'u trajtuar per vitin 2017. Pasi që në këtë total kanë ekzistuar vepra penale që nuk i përkasin kapitullit 34 të kodit penal, ka rënë numri total i personave të bartur nga 1248 në 1177. Me 01 Janar 2017, KPK raporton se nga viti 2016 jane bartur 1097 persona. KPK nuk ka raportuar se ku kanë mbetur 151 lëndë të bartura nga viti 2016. FOL, në mungesë të një sqarimi zyrtar, do të përdorë për lëndë të bartura, shifrat e raportuara me 31 Dhjetor 2016 në raportin e saj.

11 SQARIM: Ky numër reflekton numrin e veprave nga kapitulli 34 i kodit penal. Numri dallon nga numri zyrtar i raportuar nga KPK pasi janë pastruar vprat që nuk i përkasin kapitullit 34 të kodit penal.

12 SQARIM: Numri zyrtar i lëndëve në punë në raportin e dërguar nga KPK ndryshon nga numri i lëndëve në punë në raportin tone. Arsyeja qëndron në sqarimin që dhamë më lartë pasi KPK nuk ka raportuar se ku kanë mbetur 151 lëndë të bartura.

Në vitin 2017 shtatë prokuroritë themelore dhe ajo speciale në kuadër të kapitullit XXXIV të Kodit Penal të Kosovës - Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, nenet 422 – 437, kanë pranuar në punë 622 lëndë (për persona) ndërsa kanë arritur të zgjidhin 843 lëndë (për persona).

Sipas përlogaritjes, të bazuar në formulën e CEPEJ, norma e zgjidhje së lëndëve (për persona) është **135%** për vitin 2017 në nivel kombëtar në fushën e kundërkorrupsionit.

Norma e zgjidhjes së
rasteve për persona për
2017 = **135%**

Norma e zgjidhjes së lëndëve është tregues jashtëzakonisht i rendësishëm i performancës së prokurorive sepse kjo na tregon për kapacitetin punues të prokurorive. Bazuar në normën e përlogaritur në vitin 2017 prokuroria ka punuar efektivisht mbi nivelin 100%.

Norma prej 100% do të ishte e dëshirueshme sikurse prokuroritë të mos kishin lëndë të grumbulluara. Një performancë e tillë tregon se prokuroritë kanë zgjidhur më shumë lëndë (për persona), se sa kanë pranuar në punë për vitin 2017, që është indikacion se prokuroritë kanë arritur të zgjidhin edhe lëndë (për persona) të trashëguara.

Por siç do të shohim më poshtë, janë prokuroritë e veçanta ato që përmirësojnë apo përkeqësojnë performancën e prokurorisë në tërësi. Ne shpresojmë se ky raport do të jetë ndihmues për prokurorinë e shtetit, që të intervenoj në ato prokurori ku janë evidentuar problemet për të gjetur zgjidhjet e nevojshme sidomos në Prokurorinë Themelore në Ferizaj dhe Prizren të cilat kanë një performancë shumë më të dobët krahasuar me prokuroritë tjera.

Norma e qarkullimit të lëndëve

Komisioni Evropian për Efikasitetin e Gjyqësorit (CEPEJ) kërkon që sistemi i drejtësisë të raportojë një indikator të kohëzgjatjes e përfundimit të lëndëve i cili kalkulohet në dy hapa. **Së pari**, numri i lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese¹³ pjestohet me numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese që njihet edhe si “*norma e qarkullimit të lëndës*”. **Së dyti**, kjo normë e qarkullimit të lëndës pjestohet me 365¹⁴ kështu që indikator i kohëzgjatjes së përfundimit të lëndëve (DT) mund të shprehet me numrin e ditëve, për të cilin CEPEJ sugjeron se e thjeshtëzon kuptimin e marrëdhënies mes numrit të lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese dhe numrit të lëndëve që presin të zgjidhen (lëndët e bartura). DT në këtë mënyrë mat sa shpejtë sistemi i drejtësisë përfundon lëndët e pranuar në punë – që përkthehet me kohën që marrin lëndët për t’u zgjidhur (Hall & Keilitz, 2012).

13 Periudha raportuese i referohet periudhës në të cilën raportohen statistikat. Në rastin tonë pasi statistikat janë vjetore, periudhë raportuese është i gjithë viti kalendarik.

14 365 është numri i ditëve gjatë një viti kalendarik

Hapi i parë

FORMULA. $norma\ e\ qarkullimit\ të\ lëndëve = \frac{\text{numri i lëndëve të zgjidhura në fund të periudhës raportuese}}{\text{Numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese}}$

RRJEDHIMISHT: $norma\ e\ qarkullimit\ të\ lëndëve = \frac{843}{956} = 0,88$

Raporti i qarkullimit të rasteve për persona për vitin **2017** qëndron në **0,88**

Norma e qarkullimit të lëndëve në nivel kombëtar për prokurorinë për vitin 2017 qëndron në **0,88**. Koha apo norma e qarkullimit të lëndëve na jep mundësi të kuptojmë menagjimin e fluksit të lëndëve nga prokuroritë. Në përgjithësi, norma e qarkullimit të lëndëve dhe kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve krahasojnë numrin e lëndëve të

zgjidhura gjatë periudhës raportuese me numrin e lëndëve të papazgjidhura në fund të periudhës raportuese. Norma e qarkullimit mat se sa shpejt sistemi (në këtë rast i prokurorisë) i trajton lëndët që i pranon – që ndryshe i bie se sa shumë kohë merr sistemi për zgjidhjen e një lënde. Në mënyrë indirekte ky indikator jep përgjigje në njërin nga pyetjet më të shpeshta dhe më të rëndësishme në sistemin e drejtësisë, që është – sa zgjatë procedura gjyqësore, në këtë rast sa zgjatë procedura deri në ngritjen e aktakuzës (Hodzic & Georg).

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve

Nivelizimi i lëndëve me normën e zgjidhjes së lëndëve për persona **135%** do të arrihet në **vitin 2022**

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve është tregues i rëndësishëm për matjen e performancës së sistemit prokurorial. DT krahason numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese me numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese. 365¹⁵ pjestohet me normën e qarkullimit të lëndëve e gjetur në hapin e parë në mënyrë që koha të përkthehet në numrin

e ditëve. Siç shpjeguam edhe më lartë, ky indikator (DT) së bashku me normën e qarkullimit tregon se si prokuroritë menaxhojnë fluksin e lëndëve dhe sa shpejtë japin drejtësi.

Hapi i dytë

FORMULA (CEPJ). $Kohëzgjatja\ e\ përfundimit\ të\ lëndëve = \frac{365}{\text{Raporti i qarkullimit të lëndëve}}$

RRJEDHIMISHT: $Kohëzgjatja\ e\ përfundimit\ të\ lëndëve = \frac{365}{0,88} = 414\ ditë$

15 Numri i ditëve brenda një viti.

365 është numri i ditëve brenda një viti i cili pjestohet me normën e qarkullimit të lëndëve nga shtatë prokuroritë themelore dhe ajo speciale në Kosovë që për vitin 2017 ka rezultuar në 0,88.

415 ditë është koha e dhënies së drejtësisë nga sistemi. Pra, koha e shprehur në numër të ditëve brenda së cilës sistemi jep drejtësinë përfundon një lëndë ¹⁶.

Trendi i nivelizimit të lëndëve bazuar në performancën e vitit 2017

Një numër i madh i lëndëve vazhdojnë të barten nga viti paraprak duke bërë që sistemi të vonojë në dhënien e drejtësisë. Numri i lëndëve të bartura ndikon direkt në performancën e prokurorisë edhe pse niveli i performancës është mbi 100%.

Nga **1799 lëndë** (për persona), prokuroritë kanë arritur të zgjidhin **843** prej tyre, ndërsa janë bartur për vitin **2017** gjithsej **956 lëndë**

FORMULA.
$$tendi = \frac{\text{Numri i lëndëve trashëguara (PS)}}{\text{Numri i lëndëve të zgjidhura (R) - Numri i lëndëve të reja (I)}} - 1$$
 ¹⁷

RRJEDHIMISHT:
$$tendi = \frac{1177}{843 - 622} = 5 \text{ (vjet)}$$

Formula e mësipërme merr parasysh performancën e prokurorisë për vitin 2017 dhe formulohet mbi supozimin se për 5 vitet e ardhshme, prokuroria do të vazhdojë të ketë normën e njëjtë të zgjidhjes së lëndëve – 135%.¹⁸

Sa më shumë lëndë që prokuroritë bartin për vitet pasuese aq më e ulët do të jetë norma e zgjidhjes së lëndëve dhe aq më shumë sistemi do të vonojë dhënien e drejtësisë¹⁹.

Indeksi i lëndëve të grumbulluara.

Njëri ndër problemet kryesore që raportohet në sistemin e drejtësisë në Kosovë është numri i madh i lëndëve të grumbulluara ndër vite. Prokuroria sikurse gjykatat vazhdojnë të lëngojnë

16 Zakonisht, me përfundim të një lënde në prokurori kuptohet: përfundimi i hetimeve i cili mund të rezultojë me hushje të kallzimit penal, pushim të hetimeve si dhe me ngritje të aktakuzës pran gjykatës. Në praktikë puna e prokurorit nuk përfundon edhe pas ngritjes së aktakuzës pasi që procedura penale vazhdon të zhvillohet para gjykatës deri në nxerrjen e vendimit.

17 Formulës i zbritet numri 1 me qëllim që të mos llogaritet viti aktual, sepse trendi ka kuptim nëse gjendja aktuale merret si statike.

18 Ajo që nuk mund të bëhet në këtë raport në mungesë të të dhënave është përlogaritja e trendit të zgjidhjes së lëndëve ndër vite, defekt ky që shpresojmë të përmirësohet në raportet e ardhshme.

19 http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/cepej/thematiques/Au_dela_rapport/Staëa_Adiz_general_en.pdf

në këtë drejtim, megjithatë për vitin 2017 prokuroria ka një trend më të mirë të nivelizimit të lëndëve.

Numri i lartë i lëndëve të bartura bën që të rritet mosbesimi i qytetarëve në institucionet e drejtësisë pasi ata duhet të presin një kohë të gjatë që sistemi të merret me lëndët e tyre dhe të jap drejtësi.

Një indikator kyq i performancës së prokurorive është edhe numri i indeksit të lëndëve të grumbulluara. Ky indikator determinohet nga numri i lëndëve të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese i pjestuar me numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese. Një vlerë e lartë në këtë numër na tregon se duhet kohë më e gjatë për zgjidhjen e një lënde. Për shembull, nëse numri është më i lartë se 1.0, prokuroria nuk ka përfunduar aq lëndë sa ka pasur në fillim të periudhës raportuese. (Hall & Keilitz, 2012, p. 27)

Shërbimi prokurorial në nivel kombëtar për vitin 2016 ka një vlerë të indeksit të lëndëve të grumbulluara prej 1.39. Kjo vlerë është e lartë pasi prokuroria vazhdon të bartë lëndë të pazgjidhura.

Më 1999, autorja Maria Dakolias²⁰ për të vendosur në perspektivë domethënien e indeksit të lëndëve të grumbulluara raportoi një vlerë prej 0.04 për Singaporin dhe 0.25 për Francën, vlera këto që tregonin për një kohë shumë të shpejtë të përfundimit të lëndëve krahasur me shtete tjera sikurse Kili që kishte një vlerë prej 1.7 ose Ekuadori me një vlerë tepër të lartë prej 7.87. (Hall & Keilitz, 2012)

FORMULA.
$$\text{indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{\text{numri i lëndëve të bartura në fillim të periudhës raportuese}}{\text{Numri i lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese}}$$

RRJEDHIMISHT:
$$\text{indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{1177}{843} = 1.39$$

Bazuar në statistikat e vitit 2017, shërbimi prokurorial ka një vlerë të lartë të indeksit të lëndëve të grumbulluara. Ajo që duhet të ritheksohet është se ky indeks është i derivuar vetëm nga lëndët për kapitullin XXXIV të kodit penal të Kosovës – Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, nenet 422 – 437, bazuar në statistikat zyrtare nga Këshilli Prokurorial të Kosovës dhe si i tillë nuk përfaqëson të gjitha veprat penale.

Poashtu duhet të ritheksohet se asnjëri nga treguesit e mësipërm nuk tregojnë për kohën reale që lëndët specifike qëndrojnë në sistem derisa ato marrin drejtësi pasi në praktikë lëndët dallojnë shumë nga njëri tjetri.

20 See also Maria Dakolias (1999). *Court Performance around the World*. World Bank Technical Paper No. 430. Washington, DC: World Bank
<http://documents.earthbank.org/curated/en/1999/07/440392/court-performance-around-world-comparative-perspective>;

Niveli Rajonal


Më lartë prezantuar performancën e prokurorive në nivel kombëtar. Por si kanë qëndruar prokuroritë themelore ndaras? Cila prokurori ka përformuar më mirë dhe cila më dobët? Këto krahasime do të mund të i shohim në statistikat në vazhdim duke përdorur formulat e njëjta që përdorëm për nivel qendror.

Fluksi i lëndëve për prokuroritë themelore - Kapitulli XXXIV i kodit penal të Kosovës

Prokuroritë themelore dhe ajo speciale	Lëndë të pazgjidhura më 1 Janar 2017 (PS)	Lëndë të reja të hapura gjatë vitit kalendarik (I)	Lëndë në Punë (LP)	Lëndë të zgjidhura gjatë vitit kalendarik (R)	Lëndë të pazgjidhura me 31 dhjetor 2017 (PE)
P. Speciale	140	17	157	55	102
Prishtinë	610	301	911	426	485
Ferizaj	45	74	119	56	63
Mitrovicë	190	51	241	80	161
Prizren	69	25	94	21	73
Gjilan	48	80	128	81	47
Gjakovë	35	44	79	56	23
Pejë	40	56	96	68	28

SHENIM: Kryeprokurori i prokurorisë së Prizrenit z.Admir Shala, në tryezen e mbajtur me 31 Maj nga Lëvizja FOL për prezantimin e raportit, ka ofruar shifra të tjera për prokurorinë e Prizrenit, ndryshe nga ato të publikuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK). Lëvizja FOL do të përmirësoj raportin kur KPK të përmirësoj statistikat zyrtare.

Norma e zgjidhjes së lëndëve (për persona) për shtatë prokuroritë themelore si dhe për prokurorinë speciale



Bazuar në formulën për zgjidhjen e lëndëve, një performance e mirë për prokurorinë është ajo kur prokuroria trajton po aq lëndë sa ka pranuar gjatë periudhës raportuese. Tabela e mësipërme tregon se Prokuroria e Ferizajt, përcjellë nga ajo e Prizerenit kanë pasur performancën më të dobët në raportin lëndë të trajtuara pjestuar për lëndë të reja pasi ato nuk kanë arritur të trajtojnë aq lëndë sa kanë hyrë në system për 2017.

Prokuroria Speciale
dhe ajo e **Mitrovicës**
kanë pasur **performancë**
më të mirë për vitin **2017**

Ndërkaq Prokuroria Speciale, ajo e Mitrovicës dhe e Prishtinës kanë pasur performancën më të mirë. Në këtë raport, Lëvizja FOL ka bërë edhe krahasimin e normës së zgjidhjes së lëndëve me vitin 2016 për të parë normën e zgjidhjes së lëndëve në dy vite dhe për të parë fluksin e lëndëve. Këshilli Prokurorial i Kosovës mund dhe duhet të shfrytëzojë këto statistika për të menaxhuar procesin e reduktimit të lëndëve të grumbulluara në prokuroritë me fluks më të madh të lëndëve sikurse është Prishtina, Ferizaj dhe Gjilani.

Trendi i zgjidhjes së lëndëve (për persona) bazuar në statistikat e vitit 2017 për prokuroritë themelore dhe atë speciale

Prokuroritë Vite

Njësia Matëse

Trendi i nivelizimit të lëndëve dhe ofrimit të drejtësisë me vite.

Prokurori	Vite	Trendi i nivelizimit të lëndëve dhe ofrimit të drejtësisë me vite
P. Speciale	3	Dark grey (years 1-3), Light grey (years 4-47)
Prishtinë	4	Dark grey (years 1-4), Light grey (years 5-47)
Ferizaj	n/a	Red (all years)
Mitrovicë	6	Dark grey (years 1-6), Light grey (years 7-47)
Prizren	n/a	Red (all years)
Gjilan	47	Dark grey (years 1-47)
Gjakovë	2	Dark grey (years 1-2), Light grey (years 3-47)
Pejë	3	Dark grey (years 1-3), Light grey (years 4-47)

■ n/a

Bazuar në statistikat e marra nga Këshilli Prokurorial i Kosovës për vitin 2017, trendi i zgjidhjes së lëndëve në nivel qendror është pozitiv në kuptimin se shërbimi prokurorial në nivel kombëtar zgjidh më shumë lëndë se sa pranon gjatë një viti. Siç është cekur më lartë, në nivel kombëtar me normën e zgjidhjes së lëndëve 135%, prokuroria do të arrij nivelizimin në vitin 2022, por ky trend i zgjidhjes dallon shumë në nivel të prokurorive themelore.

E shprehur në vite, Prokuroria Themelore e Gjakovës ka kohën më të shpejtë të nivelizimit të lëndëve e përcjellë nga ajo Speciale e Pejës dhe Prishtinës. Arsyeja qëndron në faktin se Prokuroria Themelore e Gjakovës ka trajtuar numrin më të lartë të lëndëve që ka pasur në punë gjatë vitit 2017. Nëse fluksi i lëndëve për vitin 2018 vazhdon të jetë i njëjtë, me trendin e trajtimit të lëndëve të demonstruar në vitin 2017, Prokuroria e Gjakovës dhe ajo e Pejës do të jenë të parat të cilat do të përfundojnë lëndët e bartura në fushën e korrupsionit.

Prokuroria themelore në Ferizaj dhe Prizren kanë trend negativ për vitin 2017

Trendin më të dobët në këtë tregues e ka Prokuroria Themelore në Ferizaj e përcjellë nga ajo e Prizrenit dhe Gjilanit. Kjo pasi Ferizaj, Prizreni dhe Gjilani kanë arritur të trajtojnë shumë pak lëndë në krahasim me ato që ka trashëguar dhe ato të reja. Gjilani ka pasur një normë të lartë të qarkullimit të lëndëve (1.72), por është përballur me një fluks të madh të lëndëve të reja dhe nuk ka arritur të përballojë këtë fluks duke zgjidhur vetëm një lëndë më shumë se sa ka pranuar. Ferizaj në anën tjetër së bashku me Prizrenin kanë trend negativ.

Të dy këto prokurori nuk kanë përballuar mirë fluksin e lëndëve të reja duke zgjidhur më pak lëndë se sa kanë pranuar për vitin 2017.

Për prokuroritë që kanë trend negativ të zgjidhjes së lëndëve, formula nuk do të jetë e aplikueshme në këtë raport.

Norma e qarkullimit të lëndëve (për persona) bazuar në statistikat e vitit 2017 për prokuroritë themelore dhe atë speciale

Prokuroritë	Norma e qarkullimit të lëndëve ²¹
P. Speciale 0.53	
Prishtinë 0.87	
Ferizaj 0.88	
Mitrovicë 0.49	
Prizren 0.28	
Gjilan 1.72	
Gjakovë 2.43	
Pejë 2.42	

■ Progres ■ Regres

Me përjashtim të prokurorive themelore të Gjakovës, Pejës dhe Gjilanit të cilat kanë një normë të mirë të qarkullimit të lëndëve, të gjitha prokuroritë tjera kanë normë negative.

Prokuroritë themelore dhe ajo speciale	Lëndë të zgjidhura gjatë vitit kalendarik (R)	Lëndë të pazgjidhura në mbyllje të periudhës (PE)
P. Speciale	55	102
Mitrovicë	80	161
Prizren	21	73

Më së keqi qëndrojnë Prokuroria Themelore e Prizrenit e përcjellë nga ajo Speciale dhe e Mitrovicës. Norma e ulët e qarkullimit të lëndëve vjen si rezultat i performancës së dobët në zgjidhjen e lëndëve të trashëguara. Siç vërejtëm nga fluksi i lëndëve, Prokuroria Themelore

²¹ Sa më e madhe që të jetë norma e qarkullimit të lëndëve, aq më shumë shkurtohet koha brenda së cilës sistemi jep drejtësi pra koha për përfundimin e lëndëve.

në Prizren ka pranuar 25 lëndë të reja dhe ka zgjidhur 21 lëndë për vitin 2017, duke bartur 4 lëndë për vitin pasues. Gjakova në anën tjetër ka pranuar 44 lëndë të reja gjatë vitit 2017 por ka zgjidhur 56 lëndë duke zgjidhur kështu 12 lëndë nga lëndët e trashëguara²² nga viti 2016.

Prokuroritë themelore dhe ajo speciale	Lëndë të reja të hapura gjatë vitit kalendarik (I)	Lëndë të zgjidhura gjatë vitit kalendarik (R)	Lëndë të pazgjidhura në mbyllje të periudhës (PE)
P. Speciale	17	55	102
Gjakovë	301	426	485
Prizren	74	56	63

Prokuroria speciale në krahasim me prokurorinë e Gjakovës ka zgjidhur më shumë lëndë të trashëguara. Specialja ka zgjidhur 38 lëndë të trashëguaranga viti paraprak kurse Gjakova 12, megjithatë Specialja ka një normë të qarkullimit 0.53 kurse Gjakova 2.43 sepse Prokuroria speciale ka numër më të indeksit të lëndëve të grumbulluara (2.54) krahasuar me Gjakovën (0.62).

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve për shtatë Prokuroritë Themelore si dhe për Prokurorinë Speciale

Prokuroritë Ditë		Njësia Matëse
Kohëzgjatja e shprehur në ditë		
P. Speciale	688	
Prishtinë	419	
Ferizaj	414	
Mitrovicë	744	
Prizren	1303	
Gjilan	212	
Gjakovë	150	
Pejë	150	

Një tregues tjetër i performancës së prokurorisë është edhe kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve, që në anglisht njihet si “*disposition time (DT)*”. Ky është një tregues i rendësishëm pasi e përkthen kohën e zgjidhjes së lëndëve në ditë, duke e thjeshtuar edhe më tej kuptimin e performancës së prokurorisë në trajtimin e lëndëve.

22 Ky numër nënkupton se Givkata ka zgjidhur 12 lëndë më shumë se sa që ka pranuar.

Në përputhje me formulën e rekomanduar nga CEPEJ dhe në përputhje me rezultatet e normës së qarkullimit të lëndëve shohim se Prokuroria e Prizrenit ka performancën më të dobët me një kohëzgjatje tejet të lartë të trajtimit të lëndëve në krahasim me Gjakovën dhe Pejën. Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve merr parasysh totalin e lëndëve që presin për trajtim nga prokuroritë. Për shkak të normës së lartë të qarkullimit për vitin 2016, Prokuroria e Gjakovës dhe ajo e Pejës kanë kohën më të ulët se cilado prokurori tjetër në trajtimin e lëndëve.

Për të krahasuar, qytetarët e rajonit të Gjakovës dhe Pejës, bazuar në normën e qarkullimit të lëndëve për vitin 2017, mund të presin trajtimin e lëndëve në fushën e korrupsionit brenda 150 ditëve kurse ata në rajonin e Prizrenit dhe Mitrovicës duhet të presin për një periudhë prej 1303 dhe 744 ditëve.

Prokuroritë	Viti	Ditë	Njësia Matëse	Kohëzgjatja e shprehur në ditë
Prizren	2017	1303		
	2016	354		

Indeksi i lëndëve të grumbulluara për shtatë Prokuroritë Themelore si dhe për Prokurorinë Speciale (për persona)

Prokuroritë	Indeksi i lëndëve të grumbulluara ²³
Speciale	2.54
Prishtinë	1.43
Ferizaj	0.80
Mitrovicë	2.37
Prizren	3.28
Gjilan	0.59
Gjakovë	0.62
Pejë	0.58

Progres Regres

Duke pasur parasysh numrin e lartë të lëndëve të grumbulluara në përgjithësi në sistemin prokurorial, është i rëndësishëm një indikator i cili tregon performancën e prokurorive në këtë drejtim. Ajo që vërejmë në nivel kombëtar është se indeksi i lëndëve të grumbulluara është

²³ Sa më e madhe që të jetë norma e qarkullimit të lëndëve, aq më shumë shkurtohet koha brenda së cilës sistemi jep drejtësi, pra koha për përfundimin e lëndëve.

mjaft i lartë me 1.39. Por nga vjen ky numër i lartë i indeksit të lëndëve të grumbulluara?

Duke analizuar të dhënat për prokuroritë themelore ndaras, vërejmë se në këtë numër të lartë ndikojnë prokuroritë themelore në bazë të performances së tyre. Për vitin 2017 prokuroria e Prizrenit, Specialja dhe Mitrovica kanë numrin e indeksit më të lartë të lëndëve të grumbulluara duke kontribuar kështu në një indeks të lartë në nivel qendror. Siç e kemi theksuar më lartë, një vlerë e lartë në këtë numër tregon se duhet kohë më e gjatë për zgjidhjen e një lënde. Kur numri i lëndëve të grumbulluara është i lartë, norma e zgjidhje së lëndëve duhet të jetë tejte e lartë për të përballuar fluksin e lëndëve të reja.

Kur numri është më i lartë se 1.0, prokuroria nuk ka përfunduar aq lëndë sa ka pasur në fillim të periudhës raportuese duke bërë që lëndët e reja që hyjnë në sistem të vazhdojnë të barten dhe të presin për trajtim në një kohë të caktuar në të ardhmen. Prokuroria Speciale ka pasur 140 lëndë në fillim të periudhës kurse ka trajtuar 55 lëndë, ajo e Prizrenit ka pasur 69 dhe ka trajtuar 21 lëndë. Në anën tjetër, Gjilani ka pasur 48 lëndë të bartura dhe ka trajtuar 81 lëndë, duke demonstruar një normë shumë të lartë të qarkullimit të lëndëve dhe duke menaxhuar mire edhe fluksin e lëndëve të reja.

Performanca e **Gjykatave** në
luftën kundërkorrupsion për vitin
2017

Hyrje

Në vitin 2016 FOL raportoi se gjykatat themelore në Kosovë, në tërësi, kanë pasur një performance pozitive në luftën kundër korrupsionit. Performanca pozitive nënkuptonte që gjykatat kishin arritur të zgjidhnin më shumë lëndë se sa kishin pranuar gjatë vitit 2016.

Përkundër kësaj, trendi i zgjidhjes së lëndëve mbetej negativ, kjo pasi numri i lëndëve të bartura mbetej i lartë, sidomos në gjykatën themelore në Prishtinë.

Raporti i vitit 2016 është mirëpritur nga të gjitha gjykatat themelore dhe nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) pasi që pasqyron një gjendje reale të punës së gjykatave në Kosovë.

Raporti përdor statistikën e dalë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës të cilat janë analizuar përmes formulave zyrtare të Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ).

Për vitin 2017 vërejmë se gjykatat prapë kanë një normë pozitive të zgjidhjes së lëndëve, në kuptimin që ato kanë arritur të përballin fluksin e lëndëve kundërkorrupsion. Por fluksi i lartë i lëndëve të korrupsionit është një tregues shqetësues për nivelin e korrupsionit në Kosovë.

Luftimi dhe parandalimi i korrupsionit mbeten sfida kryesore për Kosovën. Ndërtimi dhe zhvillimi i institucioneve demokratike po pengohet nga prezenca e madhe e korrupsionit në institucionet publike.

Komisioni Evropian në raportin e vendit për Kosovën për vitin 2018 ka raportuar se *“korrupsioni mbetet i përhapur në tërë vendin dhe mbetet çështje shqetësuese dhe se nevojiten përpjekje të përbashkëta për të trajtuar këtë problem në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe strategjike (EU Commission, 2018)”*.

Korrupsioni në Kosovë është cilësuar endemik nga Komisioni Evropian në Raportin për Vendlindjen. Luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar mbeten kërkesat kryesore të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë për të hapë rrugë progresit shoqëror. Provat e

pamjaftueshme, dosja e keqpërgatitur, tërheqja nga rasti në gjykatë dhe mos guximi për të hetuar personat e hierarkisë së lartë, duhet të'i hapin rrugë guximit, profesionalizmit dhe punës me integritet tek prokurorët. E njëjta vlen edhe për gjyqtarët, kompasi moral i të cilëve duket shpesh herë i ngushtë dhe i cenushtë nga faktorë të jashtëm.

Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar është lloji më i përhapur i korrupsionit edhe për vitin 2017 sipas të gjeturave të këtij raporti. Kushtëzimi i shërbimeve publike nga zyrtarë shtetëror për përfitime personale, keqpërdorimi i pozitës zyrtare për përfitim personal, ushtrimi i presionit dhe ndikimit nga pozita zyrtare, pasurimi i paligjshëm janë të gjitha vepra korruptive të cilat po e pengojnë sundimin e ligjit dhe po rrënojnë besimin në institucione publike.

Përceptioni i lartë i prezencës së korrupsionit tek institucionet publike dhe zyrtarët qeveritar, bënë që qytetarët të varin shpresat tek prokuroria dhe gjykatat si adresat e fundit për të gjetur drejtësi dhe për të ndëshkuar të korruptuarit. Janë fillimisht prokurorët e pavarur dhe profesionalë të cilët kanë guxim të hetojnë korrupsionin në cilindo nivel dhe pastaj gjyqtarët të cilët ndajnë drejtësinë dhe vendosin nëse ligji është i barabartë për të gjithë.

Gjyqësori vazhdon të jetë ndër institucionet në të cilat qytetarët besojnë më së paku sipas pulsit publik i publikuar nga UNDP-ja për vitin 2017. Në vitin 2016 besimi i qytetarëve në gjyqësor ishte në 20%, kurse në vitin 2017 besimi është rritur në 31% (UNDP - Kosove, 2017). Megjithatë, prapë 2/3 e qytetarëve nuk besojnë në drejtësi. Ky është numër alarmues dhe gjykatat së bashku me prokurorinë duhet të adresojnë seriozisht këtë shqetësim.

Besimi i qytetarëve në gjyqësor sipas "Pulsit Publik nga UNDP – Kosovo"

2016	2017
20%	31%

Sikurse në vitin 2016, edhe në vitin 2017 vërehen përpjekje të shtuara për të trajtuar me prioritet lëndët e korrupsionit si rezultat kushtëzimit me liberalizim të vizave nga Bashkimi Evropian. Është e rëndësishme që performanca e gjyqësorit të mos jetë e ndikuar nga asnjë proces i jashtëm i cili mund të ndikoj në kualitetin e drejtësisë. Gjyqësori në vazhdimësi duhet të ketë performancë pozitive në mënyrë që të shkurtoj pritjen për drejtësi për qytetarët çka ndikon direkt në rritjen e besimit të qytetarëve në gjykata.

Sipas 'Raportit të Vendit'²⁴ nga Komisioni Evropian, gjyqësori është ende i prekshëm nga ndikimet e panevojshme politike dhe institucionet e sundimit të ligjit kërkojnë vëmendje më të madhe për të ndërtuar kapacitetet e tyre. Përkundër performances pozitive në menaxhimin e fluksit të lëndëve të korrupsionit, sipas KE administrimi i drejtësisë në tërësi mbetet i ngadalshëm dhe joefikas (EU Commission, 2018).

Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit është thelbësore për funksionimin e një shteti demokratik. Besimi i qytetarëve se ata do të përballen me një proces të drejtë nga gjyqtarë profesional dhe të pandikuar nga politika apo korrupsioni është jetik për rritjen e besimit në drejtësi.

24 Raporti për Vendin (eng. Country Report) është emërtimi i ri që Komisioni Evropian i ka vënë raportit të progresit.

Rritja e besimit të qytetarëve në institucione të drejtësisë është proces që vazhdimisht duhet të ndërtohet dhe përmirësohet.

Hapi i parë pa dyshim është rritja e kriterëve të shkëlqyeshmërisë dhe integritetit. Integriteti është kriter po aq i rëndësishëm sa kriteri profesional për një gjyqtar. Në vitin 2016, programi për fuqizimin e drejtësisë (JSSP) në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) ka ndryshuar kodin e etikës për gjyqtarë si dhe ka bërë të detyrueshëm përmes një rregulloreje ndjekjen e 4 orëve të trajnimit në etikë gjatë vitit²⁵.

Lëvizja FOL në bashkëpunim me Qendrën për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (CILC) në Holandë dhe Institutin Demokratik të Kosovës (KDI) kanë realizuar gjatë vitit 2017 një skanim të integritetit për gjyqtarë dhe prokuror i cili është publikuar në Dhejtor 2017²⁶. Raporti²⁷ ka treguar që gjyqtarët ndikohen në një masë nga faktorë të jashtëm gjatë marrjes së vendimeve çka e dëmton kredibilitetin e gjyqtarëve dhe besimin e qytetarëve në drejtësi.

JSSP ka një program trajnimi për gjyqtarët dhe FOL me partnerët është duke ndihmuar në trajnimin e disa gjyqtarëve në fushën e integritetit duke ofruar materiale për trajnim dhe trajnerë²⁸.

Hapi i dytë është hapja e gjyqësorit. Duke lejuar qytetarët të marrin pjesë dhe të shohin punën e gjyqësorit, qytetarët do të kontribuojnë jo vetëm në rritjen e besimit në institucionet e drejtësisë por që të rritet edhe cilësia e vendimeve gjyqësore²⁹. Transparenca nënkupton që vendimet e gjyqtarëve të jenë të hapura për publikun e gjërë, për studiuesit e ligjit, për avokatët, për mediat dhe shoqërinë civile.

Lëvizja FOL vazhdimisht punon për të rritur transparencën e institucioneve publike, duke përfshirë edhe gjyqësorit, si hapi i parë në luftimin e korrupsionit, keq qeverisjes dhe keqpërdorimit të parasë publike.

Publikimi i këtij raporti me statistika për punën dhe performancën e gjykatave është një hap më tepër në këtë drejtim.

Raporti hedh dritë jo vetëm për punën e gjykatave në fushën e kundërkorrupsionit, që besojmë se do të i shërbejë vetë gjykatave për t'u përmirësuar, por ai fton qytetarët që të njoftohen me punën e gjyqësorit, duke ndikuar në rritjen e besimit.

25 <https://www.usaid.gov/kosovo/fact-sheets/justice-system-strengthening-program>

26 <http://levizjafol.org/skanimi-i-integritetit-ne-sektorin-e-drejtësisë/>

27 <http://levizjafol.org/wp-content/uploads/2018/01/Skanimi-i-integritetit-n%C3%AB-Sektorin-e-Drejt%C3%ABsis%C3%AB.pdf>

28 <http://www.cilc.nl/kosovo-launch-of-justice-system-integrity-project/>

29 Lëvizja FOL ka ndërtuar platformën egjykata.org në të cilën gjenden një pjesë e mirë e vendimeve të gjykatave. Platforma nuk përmbanë të gjitha vendimet dhe nuk përditësohet me vendime të reja në mënyrë automatike.

232 lëndë të reja të korrupsionit
në vitin 2016

223 lëndë të reja të korrupsionit
në vitin 2017

Raporti tregon për një performancë pozitive të gjyqësorit në numra në trajtimin e lëndëve të korrupsionit. Fluksi i lëndëve të korrupsionit mbetet pothuasje i njëjtë me atë të vitit 2016 me një zbritje për vetëm 10 lëndë çka tregon se niveli i korrupsionit mbetet pothuajse në nivel të njëjtë.

Risi në këtë raport është edhe numri i gjyqtarëve për secilën gjykatë themelore. Ne kemi shtuar një kolonë në të djathtë të tabelës me statistika të përgjithshme lidhur me numrin e lëndëve vjetore për të treguar se sa gjyqtarë punojnë për zgjidhjen e këtyre lëndëve.

Poashtu në këtë raport kemi sjellë edhe numrin e lëndëve të parashkruara, duke përfshirë parashkrimin relativ dhe absolut.

Risi në këtë raport:

- Numri i gjyqtarëve që trajtojnë lëndët e korrupsionit në secilin gjykatë themelore
 - Numri i lëndëve të parashkruara
 - Krahasimi me raportin e vitit 2016
-

Ky raport është një përpjekje për të rritur transparencën në sektorin e drejtësisë dhe për të shtuar ndikimin në ngritjen e performancës së gjyqësorit në luftmin e korrupsionit.

Pjesa e parë e raportit jep detaje të rëndësishme në lidhje me kuptimin e punës së gjykatave dhe prokurorisë në fushën kundërkorrupsion si dhe flet për rëndësinë e raportit dhe leximin e tij.

Më pas prezantohet metodologjia e përdorur për hartimin e raportit dhe vazhdon me prezantimin e të gjeturave duke sjellë edhe statistika krahasuese në fund të raportit që mundëson të krahasohet performanca mes vitit 2016 dhe 2017.

SQARIM: Ky raport në asnjë mënyrë nuk mund të lexohet si zëvendësim i raporteve zyrtare të Këshillit Gjyqësor dhe atij Prokurorial. Raporti ka kufizimet e tij pasi nuk tregon në asnjë mënyrë për kualitetin e hetimeve nga prokurorët dhe ndarjen e drejtësisë nga gjykatësit. Raporti matë vetëm performancën në numra.

Metodologjia

Matja e performancës së gjyqësorit nuk është një punë e lehtë. Vendimet në gjykata varen nga shumë faktorë dhe një rast mund të jetë i thjeshtë ndërsa një tjetër më i komplikuar. Përveq kësaj, lëndët dallojnë njëra nga tjetra në bazë të numrit të të dyshuarve dhe lloji i veprës penale. Të gjitha këto dhe shumë të tjera, ndikojnë në kohëzgjatjen e një rasti dhe në performancën e një gjykate. Komisioni Evropian në 'Raportin e Vendi' ka kërkuar të forcohet kapaciteti për administrimin e gjykatave, në veçanti përmes funksionalizimit të një sistemi të menaxhimit të lëndëve i cili duhet të jetë në përputhje me metodologjinë e Komisionit Evropian për Matjen e Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ).

Këshilli i Evropës në janar të vitit 2018 ka publikuar Raportin e Vlerësimit të Sistemit Gjyqësor për Kosovën³⁰. Ky raport ndër të tjera jep të dhëna për lëndët penale, civile dhe administrative për gjykatat dhe prokuroritë. Megjithatë, në këtë raport nuk janë përdorë të gjitha formatat e CEPEJ, por vetëm formula e normës së zgjidhjes së lëndëve dhe kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve (Këshilli i Evropës, 2018).

Sipas Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) (CEPEJ, 2015), në përgjithësi, puna e gjyqësorit matet në dy nivele; **a) efikasiteti i gjyqësorit** që përfshin; kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore, normën e zgjidhjes së lëndëve, fluksin e lëndëve, efikasiteti për lëndë specifike, etj si dhe **b) kualiteti i gjyqësorit**, që përfshin: monitorimin dhe vlerësimin e gjykatave, strategjinë e komunikimit dhe informimit që ndihmon në uljen e kohëzgjatjes së lëndëve dhe përmirësimin e shërbimeve, trajnimin e gjykatësve dhe të tjera. Në këtë raport, Lëvizja FOL do të masë vetëm pjesën e efikasitetit të gjykatave³¹. Në këtë drejtim, FOL merr parasysh dhe mbështetet në formatat e CEPEJ për matjen e efikasitetit por edhe i përshtatë formatat duke u bazuar në statistikat që gjykatat dhe prokuroritë i kanë bërë të gatshme për publikim.

³⁰ Ky raport është financuar nga Komisioni Evropian dhe Këshilli i Evropës.

³¹ Duhet theksuar se raporti i Lëvizjes FOL nuk është raport i autorizuar nga Këshilli Evropës dhe formatat e përdorura nga CEPEJ, edhe pse janë identike, nuk janë zyrtare.

Matja nuk përfshinë gjithë sistemin gjyqësor dhe nuk përfshin të gjitha lëndët dhe llojet e veprave. Matja bëhet vetëm për një grup të veçantë të veprave penale, më saktësisht matja bëhet për kapitullin XXXIV të Kodit Penal të Kosovës – Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, nenet 422 – 437³².

Matja është statistikore dhe nuk synon të masë cilësinë e lëndëve, shërbimit të administratës gjyqësore apo kualitetin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Formulat të cilat FOL do të përdorë për matjen performancës së gjyqësorit dhe prokurorisë janë si më poshtë:

Fluksi i Lëndëve

Fluksi i lëndëve tregon numrin total të lëndëve me të cilat merret një gjykatë gjatë një viti kalendarik. Fluksi i lëndëve përfshinë lëndë të reja, lëndë të zgjidhura dhe lëndë në pritje për t'u zgjidhur. Numri i lëndëve të reja nënkupton numrin e lëndëve që futen në sistem³³ dhe që kërkojnë drejtësi; numri i lëndëve të zgjidhura është përgjigja që jep sistemi i drejtësisë pra numri i lëndëve që zgjidhen. Lëndët që priten për t'u zgjidhur janë numri i lëndëve që mbeten për t'u zgjidhur në një afat tjetër kohor dhe si të tilla janë lëndë që barten.

FORMULA. $LP=PS+I : PE=LP-R$

Shembull:

Njësia matëse:	Lëndë të pazgjidhura më 1 Janar 2017	Lëndë të reja	Lëndë në Punë	Lëndë të zgjidhura gjatë vitit kalendarik	Lëndë të pazgjidhura më 31 Dhjetor 2017
	(PS = lëndë në fillim të periudhës raportuese ³⁴)	(I)	(LP)	(R)	(PE lëndë të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese)
Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	195	106	301	123	178

Norma e zgjidhjes së Lëndëve

Është një indikator jashtëzakonisht i rëndësishëm sepse e mat raportin mes lëndëve të zgjidhura (R) dhe numrit të lëndëve të reja (I). Si i tillë, ky indikator tregon performancën e një gjykate të shprehur në përqindje duke na lehtësuar kuptimin e nivelit të përkushtimit të gjykatës në zgjidhjen e lëndëve.

32 Shiko tabelen 1: Kodi Penal i Kosovës. Kapitulli XXXIV – Korrupsioni Zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare

32 Sistem = në gjykata

33 Sistem = në gjykata

34 Këtu e tutje, me periudhë raportuese nënkuptohet periuduha brenda një viti kalendarik

FORMULA. *norma e zgjidhjes së lëndëve* % = $\frac{\text{lëndët e zgjidhura në fund të periudhës raportuese}}{\text{lëndët e reja gjatë periudhës raportuese}} \times 100$

Shembull:

Lëndët e zgjidhura në fund të periudhës raportuese (R)	123
Lëndët e reja gjatë periudhës raportuese (I)	106
Norma e zgjidhjes së lëndëve	116%

Norma e qarkullimit të lëndëve

Norma e qarkullimit të lëndëve mat raportin mes numrit të lëndëve të zgjidhura dhe numrit të lëndëve të pazgjidhura. Ky raport e mat frekuencën me të cilën sistemi gjyqësor ose gjykata e zëvendëson numrin e lëndëve të ardhura. Formula përdorë numrin e lëndëve të zgjidhura në fund të periudhës raportuese dhe e pjesëton me numrin e lëndëve të pazgjidhura duke nxjerrë një normë të qarkullimit të lëndëve. Norma e qarkullimit na tregon frekuencën me të cilën sistemi zëvendëson lëndët e reja. Norma ideale e qarkullimit duhet të jetë 100 35që nënkupton se sistemi zgjidhë po aq lëndë sa pranon gjatë vitit.

FORMULA. *norma e qarkullimit të lëndëve* = $\frac{\text{numri i lëndëve të zgjidhura në fund të periudhës raportuese}}{\text{numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese}}$

Shembull:

Numri i lëndëve të zgjidhura në fund të periudhës raportuese	123
Numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese	178
Norma e qarkullimit të lëndëve	0,69

Trendi

Mat raportin mes lëndëve të bartura dhe numrit të lëndëve të zgjidhura minus lëndët e reja. Trendi nuk është pjesë e formulës nga CEPEJ, kjo formulë është derivuar nga FOL duke marrë parasysh formulat tjera. Pasi gjykatat përballen me një numër të madh të lëndëve të pazgjidhura e kemi derivuar edhe këtë formulë për të treguar trendin në reduktimin e lëndëve. Trendi në këtë raport nënkupton performancën e gjykatave në pastrimin e lëndëve të grumbulluara. Për të lehtësuar matjen e trendit në këtë raport, Trendi këtu llogaritet duke

35 100 mund të përdoret edhe si përqindje. Shembull 100% është normë ideale e qarkullimit që nënkupton se sistemi ka zgjidhur po aq lëndë sa ka pranuar gjatë viti dhe nuk ka bartur asnjë lëndë për vitin e ardhshëm. 069 në rastin tone është norma e qarkullimit me 0.69%.

marrë si statike performancën e gjyqësorit në vitin 2017.

$$tendi = \frac{\text{Numri i lëndëve të bartura (PS)}}{\text{Numri i lëndëve të zgjidhura (R) - Numri i lëndëve të reja (I)}} - 1^{36}$$

Shembull:

Numri i lëndëve të bartura	301
Numri i lëndëve të zgjidhura	123
Minus numri i lëndëve të reja	106
Trendi	17 Vjet

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve është tregues i cili mat kohën e përfundimit të lëndëve. Formula merr parasysh tërësinë e lëndëve për një periudhë të caktuar dhe bazuar në performancën e treguar në raportin e qarkullimit të lëndëve e kthen performancën për kryerjen e lëndëve në kohëzgjatje me ditë. Ky tregues është i rëndësishëm për të parë se sa kohë merr secila gjykatë për dhënien e drejtësisë. Natyrisht matja nuk tregon për lëndët specifike pasi në realitet një lëndë mund të marrë shumë më shumë kohë se sa një tjetër, por formula merr parasysh hyrjen dhe daljen e lëndëve në sistem bazuar në performancën e treguar. Kur gjykata nuk ka lëndë të bartura, ajo trajton lëndët në kohë më të shkurtë duke bërë që drejtësia të mos vonojë.

Hapi 1 Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve = $\frac{365}{\text{Norma e qarkullimit të lëndëve}}$

Hapi 2 Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve = $\frac{365}{0.69} = 528 \text{ ditë}$

Indeksi i lëndëve të grumbulluara

Indeksi i lëndëve të grumbulluara është indikator i cili tregon performancën e gjyqësorit në përfundimin e lëndëve të grumbulluara. Numri i madh i lëndëve të grumbulluara është një ndër shqetësimet kryesore që ndikojnë direkt në vonimin e drejtësisë por edhe në rritjen e mosbesimit në gjykata. Një vlerë e lartë e indeksit të lëndëve të grumbulluara tregon se duhet kohë më e gjatë për zgjidhjen e lëndëve.

36 Formulës i zbritet numri 1 me qëllim që të mos llogaritet viti aktual, sepse trendi ka kuptim nëse gjendja aktuale merret si statike.

FORMULA. *indeksi i lëndëve të grumbulluara* = $\frac{\text{numri i lëndëve të bartura në fillim të periudhës raportuese}}{\text{Numri i lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese}}$

Shembull:

Numri i lëndëve të bartura në fillim të periudhës raportuese	195
Numri i lëndëve të zgjidhura	123
Indeksi	1.58 vjet

Performanca e gjykatave dhe prokurorive në këtë raport do të matet me këto formula dhe me këtë sistem të vlerësimit.

Mbledhja e të dhënave

Lëvizja FOL në vazhdimësi mbledh të dhënat³⁷ në fushën e korrupsionit nga gjykatat dhe prokuroritë në baza tre mujore. Në vitin 2017 ka vazhduar mbledhja e të dhënave për grupin e veprave kundërkorrupsion nga gjykatat dhe prokuroritë themelore në baza tremujore dhe vjetorë.

Gjykatat Themelore – të dhëna për të gjitha gjykatat

NENI	KATEGORIA	NENI	KATEGORIA
422	Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	432	Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore
423	Keqpërdorimi i informatës zyrtare	433	Zbulimi i fshehtësisë zyrtare
424	Konflikti i interesit	434	Falsifikimi i dokumentit zyrtar
425	Përvetësimi në detyrë	435	Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme
426	Mashtrimi në detyrë	436	Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor
427	Përdorimi i paautorizuar i pasurisë	437	Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare
428	Marrja e ryshfetit		
429	Dhënia e ryshfetit		
430	Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj		
431	Ushtrimi i ndikimit		

Tabela 1: Kodi Penal i Kosovës. Kapitulli XXXIV – Korrupsioni Zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare

Gjatë fazës së mbledhjes së informatave dhe statistikave, Lëvizja FOL ka kërkuar informata të përgjithshme dhe specifike në luftën kundërkorrupsionit. Të dhënat e përgjithshme janë

37 Të dhënat janë siguruar përmes e-mailit nga zyra për statistika në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK)

ato informata të cilat japin një pasqyrë të përgjithshme për punën e gjykatave të cilat janë të hapura për publik kurse specifike janë ato informata të cilat gjykata i përdorë për prioritete të caktuara.

Në përgjithësi, zyra për statistika në Këshillin Gjyqësor të Kosovës ka qenë bashkëpunuese dhe nuk kemi pasur pengesa në qasjen e informatave.

Në vazhdim do të japim grafikonet për të gjitha kategoritë e veprave penale në grupin e veprave “Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, nenet 422 – 437, kapitulli XXXIV i Kodit Penal të Kosovës”.

Në Tabelën 1 ne listuam të gjitha veprat penale në kuadër të kapitullit XXXIV, kurse në vazhdim do të japim një pasqyrë të përgjithshme me të gjitha statistikat nga të gjitha gjykatat themelore me të dhëna për secilën kategori pastaj do të bëjmë analizën e numrave.

	Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	Keqpërdorimi i informatës zyrtare	Konflikti i interesit	Përvetësimi në detyrë	Mashtrimi në detyrë	Përdorimi i paautorizuar i pasurisë	Marria e ryshfetit	Dhënia e ryshfetit	Dhënia ryshfetit zyrtarit publik të huaj	Ushtrimi ndikimit	Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore	Zbulimi i fshehtësisë	Falsifikimi dokumentit zyrtar	Arkëtimi dhe pagesa kundërligjshme	Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor	Mosraportimi ose raportimi i rremë i psurisë, të ardhurave, dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare	TOTALI
Lëndë të trashëguara	186	1	2	67	5	1	38	22	2	1	1	3	6	1	0	0	336
Lëndë të pranuar në punë	135	1	3	11	1	0	25	28	0	6	0	2	11	0	0	0	223
Lëndë në punë	321	2	5	78	6	1	63	50	2	7	1	5	17	1	0	0	559
Lëndë të zgjidhura	153	2	3	23	1	1	21	37	0	4	0	1	8	0	0	0	254
Dënime me burg	19	0	0	3	0	0	8	0	0	2	0	0	0	0	0	0	32
Dënime me gjobë	18	0	3	4	0	0	6	26	0	1	0	0	0	0	0	0	58
Dënime me kusht	33	1	0	7	1	1	4	7	0	1	0	0	1	0	0	0	56
Dënime tjera	2	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3
Me aktgjykim liriues	34	1	0	3	0	0	0	1	0	0	0	0	1	0	0	0	40
Me aktgjykim refuzues	15	0	0	2	0	0	0	2	0	0	0	0	2	0	0	0	21
Të zgjidhura në mënyrë tjetër	32	0	0	3	0	0	3	1	0	0	0	1	4	0	0	0	44
Parashkrimi relativ	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Parashkrimi absolut	6	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	1	0	0	0	8

Tabela 2: Pasqyrë e përgjithshme e statistikave nga gjithë gjykatat themelore për të gjitha veprat penale në kapitullin xxxiv të kodit penal të kosovës për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2017

Analiza e Numrave

FOL është munduar që numrat e mësipërm t'i zbërthejë duke përdorë një metodologji e cila i bënë më të kuptueshëm dhe të qasshëm për lexuesin. Qëllimi i këtij raporti nuk është në asnjë mënyrë që të zëvendësojë statistikën zyrtare të publikuara nga KGJK, por ne synojmë që këta numra t'i bëjmë më të kuptueshëm për qytetarët vetëm në fushën e kundërkorrupsionit. Në secilën prej tableave dhe formulave që prezantojmë mundohemi t'i përgjigjemi pyetjeve sikurse: Çka tregon tabela e mësipërme për performancën e gjyqësorit në fushën e korrupsionit? A kanë pasur gjykatat një performancë të mirë? A kanë arritur të përfundojnë lëndët në kohë? Sa kanë pritur personat e akuzuar për të marrë një vendim përfundimtar? Sa kohë merr një lëndë për t'u trajtuar nga gjykata? Cila gjykatë ka performuar më mirë?

Ajo që vërejmë nga tabela e mësipërme është se gjykatat në gjithë territorin e Kosovës kanë pasur një performancë të mirë në luftën kundërkorrupsion në kuptimin që ato kanë arritur të zgjidhin shumicën e lëndëve, në raport me numrin e lëndëve të pranuar për të njëjtën periudhë kohore.

Nga i gjithë grupi i veprave të korrupsionit, vepra penale e keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, është vepra që përsëritet më së shpeshti e që është indikacion edhe i llojit dhe nivelit të korrupsionit.

Korrupsioni zyrtar është korrupsioni i cili ushtrohet nga personi i autorizuar në një organ shtetëror, personi i zgjedhur ose i emëruar në një organ shtetëror, apo personi i cili ushtron detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj. (Kodi Penal, 2012).

Në vitin 2017, gjykatat kanë pasur në punë 578 lëndë në fushën e korrupsionit. Nga 578 lëndë, gjykatat kanë zgjidhur 254 lëndë duke bartur për vitin pasues 305 lëndë. Nëse i shiqojmë personat që kanë qenë të përfshirë në këto lëndë, del se para gjykatave në vitin 2017 kanë qenë 1204 persona. Prej tyre, për 386 persona gjykatat kanë marrë vendim, ndërsa për 818 personat tjerë procedura gjyqësore ende nuk ka përfunduar.

Numri i madh i veprave penale të kryera nga personat zyrtar është shumë më i lartë në krahasim me numrin e veprave penale të kryera nga personat jo zyrtar, që tregon qartazi për natyrën e korrupsionit në Kosovë.

Niveli qendror

Në vazhdim ne do të bëjmë analizimin e këtyre numrave përmes formulave të cilat tregojnë për kapacitetin e gjykatave themelore në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit dhe performancën e tyre për vitin 2017.

Fluksi i lëndëve

Bazuar në metodën e CEPEJ, fluksi i lëndëve do të na tregojë se si qëndron raporti mes lëndëve të reja, lëndëve të zgjidhura dhe lëndëve në pritje. Siç u tha më lartë, numri i lëndëve të reja nënkupton numrin e lëndëve që hyjnë në sistem dhe që kërkojnë drejtësi; numri i lëndëve të zgjidhura është përgjigja që jep sistemi i drejtësisë pra numri i lëndëve që zgjidhen. Lëndët që priten të zgjidhen ose lëndët e papërfunduara janë numri i lëndëve që mbeten për t'u zgjidhur nga gjykata në një kohë të caktuar dhe si të tilla janë lëndë që barten. Numri i lëndëve në punë (LP) është rezultati në mes të lëndëve të pazgjidhura nga viti paraprak (PS) plus numri i lëndëve të reja të pranuar gjatë vitit kalendarik raportues (I). Ndërkaq lëndë të pazgjidhura (PE) është diferenca mes lëndëve në punë gjatë vitit kalendarik (LP) dhe lëndëve të zgjidhura gjatë vitit kalendarik (R).

FORMULA. Formula: $LP=PS+I$; $PE=LP-R$

(**LP** = Lëndë në Punë. **PS**=Lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese. **I**=Lëndë të reja të hapura gjatë periudhës raportuese. **PE**=Lëndë të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese. **R**=Lëndë të zgjidhura gjatë vitit kalendarik).

Të gjitha gjykatat themelore	Njësia matëse: Lloji i veprës penale	Lëndë të pazgjidhura më 1 Janar 2017 (PS)	Lëndë të reja të hapura gjatë vitit kalendarik (I)	Lëndë në Punë (LP)	Lëndë të zgjidhura gjatë vitit kalendarik (R)	Lëndë të pazgjidhura më 21 Dhjetor 2017 (PE)
	Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës	355	223	578	254	324

Tabela 3 Statistikat vjetore për shtatë gjykatat themelore për vitin 2017 për veprat penale korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare.

$$(LP) 578 = PS 355 + (I) 223 \quad \text{ose} \quad (PE) 355 = (LP) 578 - (R) 254$$

Siç vërejmë nga tabela e mësipërme, për të gjitha kategoritë në kuadër të kapitullit XXXIV të Kodit Penal të Kosovës në vitin 2017 janë bartur 355 lëndë nga viti paraprak (2016). Janë pranuar 223 lëndë të reja gjatë vitit kalendarik 2017, duke bërë që gatë vitit 2017 gjykatat themelore të trajtojnë 578 lëndë.

Në nivel qendror, krahasuar me vitin 2016 ka një rënie të lëndëve të reja të korrupsionit për 9 lëndë më pak çka ka rezultuar me rënie edhe të numrit të lëndëve në punë.

Në vitin 2016 gjykatat kishin 639 lëndë në punë, kurse në vitin 2017 ky numër ka rënë në 578 lëndë, me një diferencë prej 61 lëndëve. Ky ndryshim ka ardh për dy arsye: së pari për shkak se ka rënie tek numri i lëndëve të reja të korrupsionit nga viti 2016 nga 232 sa ishin në 2016 në 223 lëndë në 2017, një diferencë prej 9 lëndëve, dhe së dyti ka rënë numri i lëndëve të bartura nga 407 sa ishin në 2016 në 355 lëndë në vitin 2017, një diferencë prej 52 lëndëve.

Norma e zgjidhjes së lëndëve

$$\text{FORMULA (CEPEJ):} \quad \text{norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura në fund të periudhës raportuese}}{\text{lëndët e reja gjatë periudhës raportuese}} \times 100$$

$$\text{RRJEDHIMISHT:} \quad \text{norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{254}{223} \times 100 = 114\%$$

Në vitin 2017 shtatë gjykatat themelore në kuadër të kapitullit XXXIV të Kodit Penal të Kosovës - Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, nenet 422 – 437, kanë pranuar në punë 223 lëndë ndërkaq kanë arritur të zgjidhin 254 lëndë.

Sipas përlogaritjes së bazuar në formulën e CEPEJ, norma e zgjidhjes së lëndëve në nivel qendror në fushën kundërkorrupsion për vitin 2017 është 114%.

Norma e zgjidhjes së lëndëve është tregues jashtëzakonisht i rëndësishëm i performancës së gjykatave sepse kjo na tregon për kapacitetin punues të gjykatave. Bazuar në normën e

përlogaritur në vitin 2017 gjykatat kanë punuar efektivisht në nivelin mbi 100%.

Norma e zgjidhjes së lëndëve për 2017 = **114%**

Norma prej 100% do të ishte e dëshirueshme sikurse gjykatat të mos kishin lëndë të grumbulluara. Performanca prej 114% tregon se gjykatat kanë zgjidhur më shumë lëndë se sa kanë pranuar në punë për vitin 2017, që është indikacion se gjykatat kanë arritur të zgjidhin edhe lëndë të bartura.

Por siç do të shohim më poshtë, janë gjykatat e veçanta ato që përmirësojnë apo përkeqësojnë performancën e gjyqësorit në tërësi. Ne shpresojmë se ky raport do të jetë ndihmues për sektorin e drejtësisë që të intervenoj në ato gjykata ku janë evidentuar problemet për të gjetur zgjidhjet e nevojshme sidomos në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila ka një performancë shumë më të dobët krahasuar me gjykatat tjera.

Norma e qarkullimit të lëndëve

Komisioni Evropian për Efikasitetin e Gjyqësorit (CEPEJ) kërkon që sistemi i drejtësisë të raportojë një indikator të kohëzgjatjes së përfundimit të lëndëve i cili kalkulohet në dy hapa. **Së pari**, numri i lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese³⁸ pjestohet me numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese që njihet edhe si “norma e qarkullimit të lëndëve”.

Nga 578 lëndë për **vitin 2017** gjykatat kanë arritur të zgjidhin **254** prej tyre ndërsa janë bartur për **vitin 2018** gjithsej **324 lëndë**

Së dyti, kjo normë e qarkullimit të lëndëve pjestohet me 365^{*} kështu që indikator i kohëzgjatjes së përfundimit të lëndëve (DT) mund të shprehet me numrin e ditëve, për të cilin CEPEJ sugjeron se e thjeshtëzon kuptimin e marrëdhënies mes numrit të lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese dhe numrit të lëndëve që presin të zgjidhen (lëndët e bartura). DT në këtë mënyrë mat se sa shpejtë sistemi i drejtësisë përfundon lëndët e pranuar në punë – që përket me kohën që marrin lëndët për t’u zgjidhur (Hall & Keilitz, 2012).

Hapi i parë

FORMULA.
$$\text{norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{\text{numri i lëndëve të zgjidhura në fund të periudhës raportuese}}{\text{Numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese}}$$

RRJEDHIMISHT:
$$\text{norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{254}{324} = 0,78$$

Norma e qarkullimit të lëndëve edhe për vitin 2017 qëndron në 0,8. Sipas Dakolias (Dakolias, 1999), norma normale e qarkullimit të lëndëve është 1.0 ose 100% shprehur në përqindje. Norma 1.0 nënkupton se sa lëndë hyjnë në sistem brenda një viti po aq dalin nga sistemi.

38 Periudha raportuese i referohet periudhës në të cilën raportohen statistikat. Në rastin tonë pasi statistikat janë vjetore, periudhë raportuese është i gjithë viti kalendarik.

* 365 është numri i ditëve gjatë një viti kalendarik.

Shembull: Nëse 50 lëndë janë pranuar gjatë vitit 2017 dhe 50 janë zgjidhur, norma e qarkullimit është 1.0.

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve

Raporti i qarkullimit të lëndëve për vitin **2017 qëndron në 0,78**

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve është tregues i rëndësishëm për matjen e performancës së sistemit gjyqësor. DT krahason numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese me numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese. 365³⁹ pjestohet me normën e qarkullimit të lëndëve në mënyrë që koha të përkthehet në numrin e ditëve. Ky indikator (DT) tregon se si gjykatat menaxhojnë fluksin e lëndëve dhe sa shpejtë ato japin drejtësi.

Hapi i dytë

FORMULA (CEPJ). $\text{Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve} = \frac{365}{\text{Norma e qarkullimit të lëndëve}}$

RRJEDHIMISHT: $\text{Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve} = \frac{365}{0.78} = 467,95 \text{ ditë}$

365 është numri i ditëve brenda një viti i cili pjestohet me normën e qarkullimit të lëndëve nga shtatë gjykatat themelore në Kosovë që për vitin 2017 ka rezultuar në 0,78.

468 është koha e dhënies së drejtësisë nga sistemi. Pra, koha e shprehur në numër të ditëve brenda së cilës sistemi jep drejtësinë ose përfundon një lëndë. Sa më e lartë të jetë norma e qarkullimit të lëndëve, aq më shumë shkurtohet koha brenda së cilës sistemi jep drejtësi pra koha për përfundimin e lëndëve.⁴⁰

Trendi i nivelizimit të lëndëve bazuar në performancën e vitit 2017

Një numër i madh i lëndëve vazhdojnë të barten nga viti paraprak duke bërë që sistemi të vonojë në dhënien e drejtësisë. Numri i lëndëve të bartura ndikon direkt në performancën e gjyqësorit edhe pse niveli i performancës është mbi 100%.

Nga përlogaritja, nëse marrim për bazë normën zgjidhjes së lëndëve të treguar për vitin 2017, gjykatat do të arrijnë të përfundojnë lëndët e bartura në vitin 2027.

39 Numri i ditëve brenda një viti.

40 http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/cepej/thematiques/Au_dela_rapport/Stawa_Adiz_general_en.pdf

FORMULA.
$$trendi = \frac{\text{Numri i lëndëve të bartura (PS)}}{\text{Numri i lëndëve të zgjidhura (R) - Numri i lëndëve të reja (I)}} - 1$$

RRJEDHIMISHT:
$$trendi = \frac{355}{254 - 223} = 11 \text{ (vjet)}$$

Nivelizimi i lëndëve me normën e zgjidhjes së lëndëve **114%** do të arrihet në **vitin 2028**

Formula e mësipërme merr parasysh performancën e gjyqësorit për vitin 2017 dhe formulohet mbi supozimin se për 11 vitet e ardhshme gjyqësori do të vazhdojë të ketë normën e njëjtë të zgjidhjes së lëndëve – 114%.⁴¹

Sa më shumë lëndë që gjykatat bartin për vitet pasuese aq më e ulët do të jetë norma e zgjidhjes së lëndëve dhe aq më shumë sistemi do të vonojë dhënien e drejtësisë⁴².

Indeksi i lëndëve të grumbulluara.

Njëri ndër problemet kryesore që raportohet në sistemin e drejtësisë në Kosovë është numri i madh i lëndëve të grumbulluara ndër vite. Sipas statistikave zyrtare, llogaritet se në Kosovë janë mbi 400,000 lëndë të papërfunduara (European Commission, 2016). Ky numër kaq i lartë i lëndëve bën që të rritet mosbesimi i qytetarëve në institucionet e drejtësisë pasi ata duhet të presin një kohë të gjatë për drejtësi.

Sipas statistikave zyrtare, llogaritet se në Kosovë janë **mbi 400,000** (European Commission, 2016)

Një indikator kyç i performancës së gjyqësorit është edhe numri i indeksit të lëndëve të grumbulluara. Në botë, shumë gjykata mbështeten në “indeksin e lëndëve të grumbulluara” (eng. backlog index), për të treguar nivelin e performancës së gjykatës. Ky indikator determinohet nga numri i lëndëve të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese i pjestuar me numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës

raportuese. Një vlerë e lartë në këtë numër na tregon se duhet kohë më e gjatë për zgjidhjen e lëndëve. Për shembull, nëse numri është më i lartë se 1.0, gjykata nuk ka përfunduar aq lëndë sa ka pasur në fillim të periudhës raportuese. (Hall & Keilitz, 2012, p. 27)

Më 1999, autorja Maria Dakolias⁴³ për të vendosur në perspektivë domethënien e numrave raportoi një vlerë prej 0.04 për Singaporin dhe 0.25 për Francën, vlera këto që tregonin për një kohë shumë të shpejtë të përfundimit të lëndëve krahasur me shtete tjera sikurse Kili që kishte një vlerë prej 1.7 ose Ekuadori me një vlerë tepër të lartë prej 7.87. (Hall & Keilitz, 2012)

41 Ajo që nuk mund të bëhet në këtë raport në mungesë të të dhënave është përlogaritja e trendit të zgjidhjes së lëndëve ndër vite, defekt ky që shpresojmë të përmirësohet në raportet e ardhshme.

42 http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/cepej/thematiques/Au_dela_rapport/Staëa_Adiz_general_en.pdf

43 See also Maria Dakolias (1999). *Court Performance around the World*. World Bank Technical Paper No. 430. Washington, DC: World Bank <http://documents.worldbank.org/curated/en/1999/07/440392/court-performance-around-world-comparative-perspective>;

FORMULA. $\text{indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{\text{numri i lëndëve të bartura në fillim të periudhës raportuese}}{\text{Numri i lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese}}$

RRJEDHIMISHT: $\text{indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{335}{254} = 1.40$

Bazuar në statistikat e vitit 2017, Kosova ka një vlerë të lartë të indeksit të lëndëve të grumbulluara. Ajo që duhet të ritheksohet është se ky indeks është i derivuar vetëm nga lëndët për kapitullin XXXIV të Kodit Penal të Kosovës – Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, nenet 422 – 437, bazuar në statistikat zyrtare nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe si i tillë nuk përfaqëson të gjithë sistemin gjyqësor. Poashtu duhet të ritheksohet se asnjëri nga treguesit e mësipërm nuk tregojnë për kohën reale që lëndët specifike qëndrojnë në sistem derisa ato marrin drejtësi.

Indeksi i lëndëve të
grumbulluara për vitin 2017
është **1.40**


Niveli Rajonal

Më lartë prezantuar performancën e gjykatave në nivel qendror. Por si kanë qëndruar gjykatat themelore ndaras? Cila gjykatë ka performuar më mirë dhe cila më dobët? Këto krahasime do të mund të shohim në statistikat në vazhdim duke përdorur formulat e njëjta që përdorëm për nivel qendror.

Fluksi i lëndëve për gjykatat themelore - Kapitulli XXXIV i kodit penal të Kosovës

Gjykatat Themelore	Lëndë në fillim të periudhës raportuese. Lëndë të trashëguara (PS)	Lëndë të reja të hapura gjatë vitit kalendarik (I)	Lëndë në Punë (LP)	Lëndë të zgjidhura gjatë vitit kalendarik (R)	Lëndë të pazgjidhura në mbyllje të periudhës (PE)	Nr i gjykatesve ne dep e krimeve te renda, sipas gjykatave
Prishtinë	198	73	271	88	183	13+1
Ferizaj	18	19	37	27	10	4+1
Mitrovicë	19	20	39	12	27	4+1
Prizren	38	27	65	36	29	6
Gjilan	48	37	85	38	47	4
Gjakovë	12	17	29	16	13	3+1
Pejë	22	30	52	37	15	4+1

Norma e zgjidhjes së lëndëve për shtatë gjykatat themelore



Bazuar në formulën për zgjidhjen e lëndëve, një performancë e mirë për gjykatën është ajo kur gjykata zgjidh po aq lëndë sa ka pranuar gjatë periudhës raportuese. Tabela e mësipërme tregon se Gjykata e Mitrovicës, përcjellë nga ajo e Gjakovës kanë pasur performancë më të dobët në raportin lëndë të zgjidhura pjestuar për lëndë të reja. Ndërkaq Ferizaj dhe Prizreni kanë pasur performancën më të mirë.

Gjykatat Themelore në Prishtinë	Lëndë në fillim të periudhës raportuese. Lëndë të trashëguara (PS)	Lëndë të reja të hapura gjatë vitit kalendarik (I)	Lëndë në Punë (LP)	Lëndë të zgjidhura gjatë vitit kalendarik (R)	Lëndë të pazgjidhura në mbyllje të periudhës (PE)	Nr i gjykatesve ne dep e krimeve te renda, sipas gjykatave
2017	198	73	271	88	183	13+1
2016	193	81	274	76	198	

Gjykata Themelore (GJ.Th) në Prishtinë në vitin 2016 kishte performancë shumë të dobët krahasuar me gjykatat tjera edhe pse kishte një fluks të ngjashëm me fluksin që ka në vitin 2017. Në vitin 2016 Gjykata Themelore e Prishtinës kishte trashëguar 193 lëndë nga viti 2015, kishte pranuar 81 lëndë të reja dhe kishte zgjidhur 76 lëndë duke performuar me një normë të zgjidhjes së lëndëve prej 93%. Në vitin 2017 Prishtina ka trashëguar 198 lëndë nga viti 2016, ka pranuar 73 lëndë të reja dhe ka zgjidhur 88 lëndë duke treguar një performancë prej 120%, duke rritur kështu për 27% performancën nga viti paraprak.

Ky rezultat i Gj.Th në Prishtinë vjen pasi ka zgjidhur 13 lëndë më shumë se sa ka pranuar në vitin 2017, kurse në vitin 2016 kishte zgjidhur 5 lëndë më pak se sa kishte pranuar (Shiko grafikonet me krahasime në fund të raportit).

Gjakova në anën tjetër kishte normën dhe më të mirë të zgjidhjes së lëndëve nga të gjitha gjykatat tjera. Në vitin 2017, nga norma 315%, Gjakova ka rënë në normën 94%, një rënie prej 221%.

Çka ka ndikuar në rënien e performancës në Gjykatën Themelore në Gjakovë?

Pasi raporti dhe matja është kryesisht statistikore, ne shikojmë fluksin e lëndëve me të cilin është përballur Gjykata Themelore në Gjakovë në vitin 2017 duke e krahasuar me atë të vitit 2016.

Gjykatat Themelore në Gjakovë	Lëndë në fillim të periudhës raportuese. Lëndë të trashëguara (PS)	Lëndë të reja të hapura gjatë vitit kalendarik (I)	Lëndë në Punë (LP)	Lëndë të zgjidhura gjatë vitit kalendarik (R)	Lëndë të pazgjidhura në mbyllje të periudhës (PE)	Nr i gjykatesve ne dep e krimeve te renda, sipas gjykatave
2017	12	17	29	16	13	3+1
2016	40	13	53	41	12	

Nga tabela e mësipërme shohim se Gjakova, si rezultat i performancës në vitin 2016 ka arritur të reduktoj numrin e lëndëve të bartura nga 40 që kishte në fillim të vitit 2016 në 12 në fillim të vitit 2017. Megjithatë, performanca në zgjidhjen e lëndëve ka rënë nga 41 lëndë të zgjidhura në vitin 2016 në 16 lëndë për vitin 2017.⁴⁴

Ferizaj dhe **Prizreni** kanë pasur normën më të mirë të zgjidhjes së lëndëve për vitin 2017

Mitrovica dhe **Gjakova** kanë pasur performancën më të dobët.

Në këtë raport, Lëvizja FOL nuk ka bërë krahasim të normës së zgjidhjes së lëndëve ndër vite për të parë nëse fluksi i lëndëve është i njëjtë edhe për periudhat e mëhershme⁴⁵ Nëse një trend i tillë i fluksit të lëndëve vazhdon edhe për vitin 2017, Këshilli Gjyqësor i Kosovës mund dhe duhet të shfrytëzojë këto statistika për të menaxhuar procesin e reduktimit të lëndëve të grumbulluara në gjykatat me fluks më të madh të lëndëve dhe me indeks të grumbullimit të lëndëve më të lartë.

44 Shihni në fund të raportit për një krahasim të plotë të të gjitha gjykatave.

45 Një matje e tillë do të bëhet në raportet e ardhshme

Trendi i zgjidhjes së lëndëve bazuar në statistikat e vitit 2017 për shtatë gjykatat themelore

Gjykatat Themelore	Vite	Njësia Matëse
		Trendi i nivelizimit të lëndëve dhe ofrimit të drejtësisë me vite.
Prishtinë	13	
Ferizaj	2	
Mitrovicë	n/a	
Prizren	4	
Gjilan	47	
Gjakovë	n/a	
Pejë	3	

■ n/a

Bazuar në statistikat e marra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për vitin 2017, trendi i zgjidhjes së lëndëve në nivel qendror është pozitiv në kuptimin se gjyqësori në nivel kombëtar zgjidh më shumë lëndë se sa pranon gjatë një viti. Siç është cekur më lartë, në nivel kombëtar me normën e zgjidhjes së lëndëve në nivel 114%, gjyqësori do të arrij nivelizimin në vitin 2028, por ky trend i zgjidhjes dallon shumë në nivel të gjykatave themelore.

Gjykata Themelore e Mitrovicës nga 20 lëndë të reja ka zgjidhur vetëm 12 duke bartur 8 lëndë për vitin pasues. Në përgjithësi, gjykatat themelore e kanë përballuar mirë fluksin e lëndëve për vitin 2017, edhe pse fluksi i lëndëve nuk ka shënuar rënie të madhe.

Numri i lëndëve të korrupsionit kashënuar **rënie** në **Prishtinë** dhe **Gjilan**.

Numri i lëndëve të korrupsionit është **rritur** në **Gjakovë** dhe në **Pejë**.

Gjykatat që kanë pësuar rënien më të madhe të lëndëve të reja janë Gjilan, i cili ka një diferencë prej 4 lëndëve, dhe Peja me 3 lëndë më pak se në vitin 2016.

Gjakova ka shënuar rritje në lëndët e reja të korrupsionit nga 13 lëndë sa kishte në 2016, në 17 lëndë në vitin 2017.

Kur krahasohen statistikat e vitit 2016 me atë të vitit 2017 shohim se korrupsioni nuk ka shënuar rënie aspak në vitin 2017 dhe se numri i rasteve të reja sillet në nivele të njëjta. Prishtina ka pasur 81 lëndë të reja në vitin 2016 kurse në vitin 2017 ka shënuar rënie për 8 lëndë duke pranuar vetëm 73 lëndë të reja. Megjithatë, Prishtina ka zgjidhur 15 lëndë më shumë se që ka pranuar në vitin 2017 duke treguar një performancë të mirë.


Megjithatë, numri i lëndëve të bartura vazhdon të jetë i madh në Prishtinë duke bërë që drejtësia të vonojë në Gjykatën Themelore të Prishtinës më shumë se në gjykata tjera.

Gjykatat themelore me **më së shumti lëndë në punë dhe lëndë të reja të korrupsionit** janë **Prishtina** dhe **Gjilani**

Ajo që është për t'u shqetësuar është trendi negativ i zgjidhjes së lëndëve. Trend negativ i zgjidhjes së lëndëve nënkupton që gjykatat zgjidhin më pak lëndë se sa që pranojnë gjatë vitit kalendarik. Gjykata me trendin më të madh negativ në vitin 2017 është Mitrovica duke zgjidhur 8 lëndë më pak se që ka pranuar dhe duke shtuar këto lëndë tek lëndët e bartura, pastaj Gjakova e cila ka zgjidhur një lëndë më pak se që ka pranuar në vitin 2017.

Nëse marrim për bazë fluksin e lëndëve (lëndët e reja) dhe normën e zgjidhjes së lëndëve për vitin 2017, Mitrovica dhe Gjakova nuk do të mund të bëjnë nivelizimin e lëndëve. Kjo pasi për të zgjidhur lëndët e grumbulluara gjykatat duhet të kenë trend pozitiv duke performuar me një normë më të lartë se 100% të zgjidhjes së lëndëve. Rrjedhimisht, për të gjitha gjykatat të cilat kanë trend negativ të zgjidhjes së lëndëve, formula nuk do të jetë e aplikueshme në këtë raport – N/A.

Norma e qarkullimit të lëndëve për shtatë gjykatat themelore



⁴⁶ Sa më e madhe që të jetë norma e qarkullimit të lëndëve, aq më shumë shkurtohet koha brenda së cilës sistemi jep drejtësi pra koha për përfundimin e lëndëve.

Norma e qarkullimit të lëndëve në nivel kombëtar për vitin 2017 qëndron në 0,83. Norma normale e qarkullimit të lëndëve është 1.0. Norma 1.0 nënkupton se sa lëndë hyjnë në sistem brenda një viti po aq dalin nga sistemi. Gjykatat që kanë një numër të madh të lëndëve të grumbulluara kërkohet që të kenë një normë më të lartë se 1.0 të qarkullimi të lëndëve. Por, siç vërejmë nga tabela e më poshtme, disa gjykata edhe pse kanë normë të mirë të zgjidhjes së lëndëve, kanë numër negativ të qarkullimit të lëndëve, kjo për shkak të numrit të madh të lëndëve të grumbulluara.

Gjykata Themelore e Prishtinës, e cila ka nivelin më të lartë të lëndëve të grumbulluara, ka normë të ulët të qarkullimit prej 0.48, kurse Gjykata Themelore e Mitrovicës e cila nuk ka një numër të madh të lëndëve të bartura por ka një normë të ulët të zgjidhjes së lëndëve po ashtu ka një normë të ulët të qarkullimit.

Kjo është arsyeja pse Prishtina me normë të mirë të zgjidhjes së lëndëve për vitin 2017 ka një normë të ulët të qarkullimit, kurse Mitrovica me një normë tejet të ulët të zgjidhjes së lëndëve po ashtu ka normën e ulët të qarkullimit. Norma e qarkullimit varet nga dy faktorë të rëndësishëm. E para, duhet që norma e zgjidhjes së lëndëve të jetë 100%, pastaj numri i lëndëve të grumbulluara të jetë i ulët sepse nëse numri i lëndëve të grumbulluara është tejet i lartë, sikurse në rastin e Prishtinës, norma e zgjidhjes së lëndëve prej 100% është e pamjaftueshme pasi nuk arrin të reduktoj lëndët e grumbulluara.

E dyta, edhe kur ka një numër të ulët të lëndëve të bartura (sikurse në rastin e Mitrovicës), norma e ulët (nën 100%) e zgjidhjes së lëndëve bënë që lëndët të barten, pra gjykata nuk përfundon aq lëndë sa hyjnë në sistem, si rrjedhojë norma e qarkullimit del e ulët.

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve për shtatë gjykatat themelore

Gjykata Themelore	Ditë	Njësia Matëse Kohëzgjatja e shprehur në ditë
Prishtinë	760	
Ferizaj	135	
Mitrovicë	829	
Prizren	294	
Gjilan	450	
Gjakovë	304	
Pejë	152	

Një tregues tjetër i performancës së gjyqësorit është edhe kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve, që në anglisht njihet si “*disposition time (DT)*”. Ky është një tregues i rëndësishëm pasi e përkthen kohën e zgjidhjes së lëndëve në ditë, duke e thjeshtuar edhe më tej kuptimin


e performancës së gjyqësorit në dhënien e drejtësisë.

Në përputhje me formulën e rekomanduar nga CEPEJ dhe në përputhje me rezultatet e normës së qarkullimit të lëndëve shohim se Gjykata e Mitrovicës ka performancën më të dobët me një kohëzgjatje tejet të lartë për zgjidhjen e lëndëve në krahasim me gjykatat tjera. Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve merr parasysh totalin e lëndëve që presin për dhënie të drejtësisë para gjykatës.

Gjykata e Mitrovicës dhe e ajo e Prishtinës kanë kohën më të gjatë të pritjes për drejtësi se sa të gjitha gjykatat tjera, por cilat janë arsyet për këtë kohë kaq të gjatë?

Mitrovica ka pasur një normë tejet të ulët të zgjidhjes së lëndëve për vitin 2017, gjegjësisht prej 60%. Norma e ulët e zgjidhjes së lëndëve bënë që lëndët të barten për vitin pasues dhe si rrjedhojë zgjatet koha e dhënies së drejtësisë. Prishtina në anën tjetër ka kohën e dytë më të gjatë pas Mitrovicës në zgjidhjen e lëndëve të shprehur në ditë sepse ka një numër të lartë të lëndëve të bartura. Pra edhe pse norma e zgjidhje së lëndëve për vitin 2017 është mbi 100%, numri i madh i lëndëve të bartura kërkon një normë shumë më të lartë se 100% në vazhdimësi për të reduktuar numrin e lëndëve të bartura.

Indeksi i lëndëve të grumbulluara për shtatë gjykatat themelore



Duke pasur parasysh numrin e lartë të lëndëve të grumbulluara në përgjithësi në sistemin gjyqësor, është i rëndësishëm një indikator i cili tregon performancën e gjykatave në këtë drejtim. Ajo që vërejmë në nivel kombëtar është se indeksi i lëndëve të grumbulluara është mjaft i lartë me 1.4.

⁴⁷ Sa më e madhe që të jetë norma e qarkullimit të lëndëve, aq më shumë shkurtohet koha brenda së cilës sistemi jep drejtësi, pra koha për përfundimin e lëndëve.

Por nga vjen ky numër i lartë i indeksit të lëndëve të grumbulluara?

Duke analizuar të dhënat për gjykatat themelore ndaras, vërejmë se në këtë numër të lartë kontribuon Gjykata Themelore në Prishtinë pasi ka numrin më të lartë të lëndëve të grumbulluara e përcjellë nga Gjilani. Mitrovica në anën tjetër nuk ka numër të lartë të lëndëve të bartura krahasuar me Prishtinën dhe Gjilanin, por ka një normë të ulët të zgjidhjes së lëndëve çka rezulton me një numër të lartë të indeksit.

Performanca që një gjykatë tregon në zgjidhjen e lëndëve gjatë vitit i ndikon të gjithë indikatorët tjerë. Një vlerë e lartë e indeksit të lëndëve të grumbulluara tregon se duhet kohë më e gjatë për zgjidhjen e një lënde duke bërë që sistemi të vonojë në dhënien e drejtësisë. Kur numri është më i lartë se 1.0, gjykata nuk ka përfunduar aq lëndë sa ka pasur në fillim të periudhës raportuese, duke bërë që lëndët e reja që hyjnë në sistem të vazhdojnë të barten dhe të presin për drejtësi në një kohë të caktuar në të ardhmen.

Shembull, nga tabela mësipër vërejmë se Mitrovica ka një numër 1.58 të indeksit të lëndëve të grumbulluara. Mitrovica në fillim të periudhës raportuese ka pasur 19 lëndë të bartura dhe ka arritur të zgjidhë 12 prej tyre. Prishtina në anën tjetër ka një numër të indeksit 2.25. Prishtina ka pasur 198 lëndë të bartura në fillim të periudhës raportuese, kurse ka zgjidhur vetëm 88 prej tyre. Prishtina ka trend pozitiv të zgjidhjes së lëndëve në kuptimin që ka një normë prej 120% të zgjidhjes çka ndikon në reduktimin e lëndëve të bartura, por siç e kemi dhënë më lart, ky trend nënkupton që nivelizimi i lëndëve të arrihet në 13 vitet ardhshme.

Gjykatat Themelore / Statistikat antikorrupsion për persona - 2017

Gjykatat Themelore dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet që statistikatat e mësipërme të i lexojnë me kujdes dhe të luajnë rolin e tyre në ngritjen e performancës në ato gjykata ku ka ngecje, sikurse ajo e Mitrovicës.

Në 578 lëndë në punë që kanë qenë për vitin 2017, 1204 persona kanë pritur drejtësi nga gjykatat.

Grafikonët e mëposhtëm tregojnë statistikatat kundërkorrupsion të shprehur në persona dhe jo në lëndë. Arsyeja pse kemi zgjedhur të tregojmë numrat në vend të lëndëve në pjesën e mëposhtme është për të thjeshtuar për qytetarët punën e gjykatave në luftën kundërkorrupsionit.

Lëndët për Persona

Gjykatat Themelore	Prishtinë	Gjilan	Prizren	Mitrovicë	Gjakovë	Pejë	Ferizaj	Totali
Persona para gjykatave	662	185	108	43	35	108	63	1204
Persona për të cilat gjykata ka marrë vendim	149	38	79	13	18	47	42	386
Persona ndaj të cilëve nuk ka përfunduar procedura gjyqësore	513	147	29	30	17	61	21	818
Persona të dënuar me burg	21	1	9	1	0	2	9	43
Persona të dënuar me gjobë	17	10	8	6	5	14	7	67
Persona të dënuar me kusht	31	4	26	1	4	12	6	84
Dënime tjera	0	1	0	0	0	4	0	5
Me aktgjykim liriues	26	11	20	1	3	6	3	70
Me aktgjykim refuzues	16	3	2	2	0	2	7	32
Të zgjidhura në mënyrë tjetër	38	8	14	2	6	7	10	85

Përfundim

Fluksi i lëndëve të reja të korrupsionit vazhdon të mbetet i lartë. I lartë mbetet edhe numri i lëndëve të trashëguara, faktorë këta që po ndikojnë në kualitetin dhe vonimin e hetimeve dhe në vonimin e drejtësisë në përgjithësi.

Sikurse në vitin 2016, performanca e gjykatave dhe prokurorive mbetet e lartë dhe pozitive në nivel qendror, kurse në nivel lokal disa gjykata dhe disa prokurori kanë performancë më të mirë e disa më të dobët. Gjykata themelore e Prishtinës ka ngritë performancën nga 93% në vitin 2016 në 120% në vitin 2017 kurse ajo e Gjakovës ka ulë performancën nga 315% në vitin 2016 në 94% në vitin 2017.

Prokuroria themelore në Mitrovicë ka ngritë performancën nga 66% në vitin 2016 në 156% në vitin 2017 kurse ajo e Ferizajt ka mbetur me performancë negative në vitin 2017 (75%) sikurse në vitin 2016 (87%).

Lëvizja FOL përmes këtij raporti është duke u munduar të i japë kuptim numrave zyrtar të publikuar nga KGJK dhe KPK në luftën kundërkorrupsion dhe duke ofruar një pasqyrë për gjykatat dhe prokuroritë që të shohin dhe të maten me vetveten.

FOL ndanë shqetësimin për nivelin e lartë të korrupsionit që shihet tek fluksi i lartë i lëndëve të korrupsionit. Në vitin 2017 prokuroritë kanë pasë në trajtim për korrupsion 1799 persona ndërkaq 1204 persona kanë pritur drejtësi para gjykatave për po të njejtat vepra penale.

Në një shtet me 1.8 milion banorë këto shifra janë alarmante dhe duhet të lexohen jo vetëm nga gjykatat dhe prokuroritë por nga qeveria dhe gjithë shoqëria. Mbi 90% e personave të akuzuar për korrupsion janë zyrtarë publikë, shifër kjo e cila flet edhe për natyrën e korrupsionit dhe për faktin se sa e korruptuar është e gjithë administrata shtetërore.

Besimi i qytetarëve në institucionet e drejtësisë nuk arrihet për një ditë. Për afër dy dekada qytetarët janë ndjerë të zhgënjyer me punën e gjykatave dhe prokurorisë duke pritur me vite

të tëra për drejtësi, prandaj kërkohet një punë shumë e madhe për të fituar besimin.

Ky raport është vetëm një nga përpjekjet për të afruar qytetarët më afër drejtësisë përmes shpjegimit të punës së gjykatave dhe prokurorive.

Përceptimi mund të luftohet vetëm përmes argumenteve të bazuara në fakte.

Ky raport bënë pikërisht këtë, në njërën anë ndihmon qytetarët për të kuptuar punën e gjyqësorit kurse në anën tjetër ndihmon gjyqësorin për të rritur performancën.

Lëvizja FOL do të vazhdojë të publikoj raporte periodike dhe vjetore për punën e gjykatave dhe prokurorive.

Bibliografia

European Commission . (2016, May 4). <http://europa.eu/rapid/search.htm>. Gjetur March 02, 2017, nga <http://europa.eu>: http://europa.eu/rapid/press-release_IP-16-1626_en.htm

CEPEJ. (2015). *CEPEJ Guidelines*.

COMMISSION, E. (2015). *COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT. KOSOVO* 2015 REPORT*. EUROPEAN COMMISSION. Brussels: EUROPEAN COMMISSION.

Dakolias, M. (2014). Court Performance Around the World: A Comparative Perspective. *Yale Human Rights and Development Journal* , Volume 2 (Issue 1 Yale Human Rights and Development Journal), 57.

Dakolias, M. (1999). *Court Performance Around the World: A Comparative Perspective. Volumes 23-430*.

Department of State, U. (2015). *Kosovo Human Rights Report*.

EU Commission. (2018). *Country Report*. Strasbourg: European Commission.

Hall, D. H., & Keilitz, I. (2012). *Global Measures of Court Performance*. Discussion Draft Version 3. International Framework for Court Excellence.

Hall, D. H., & Keilitz, I. (2012). *Global Measures of Court Performance. Discussion Draft Version 3*.

Hodzic, A., & Georg, S. *What can be said on clearance rate and disposition time (and some more)?*

Keshilli i Evropes. (2018). *Vleresimi i sistemit gjyqesor ne Kosove*. Strasbourg: Keshilli i Evropes.

KGJK. (2016). *Raporti vjetor per Grupin e veprave penale qe lidhen me korrupsion*.

KGJK. (2013). *Strategjia Kombëtare për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra*.

Kodi Penal, i. R. (2012). *Korrupsioni Zyrtar dhe Veprat Penale kundër Detyrës Zyrtare*.

KPK. (2016). *Raporti Vjetor per Grupin e Veprave Penale qe lidhen me Korrupsion*.

Maliqi, A. (2016). Intervistë rreth strategjisë për reduktimin e lëndëve antikorruption në gjykata.

Prokurori i Shtetit, Z. (2015). *Strategjia - Prioritetet e Prokurorive Themelore në Kosovë në ndjekjen e kryesve të veprave penale dhe hetimin e veprave penale në përgjithësi dhe reduktimin e numrit të lëndëve.*

UNDP - Kosove. (2017). *Pulsi Publik XIII*. Ankete, UNDP - Kosove, Prishtine.

Shtojca I. Statistika krahasuese për prokuroritë 2016 - 2017

Niveli Qendror / Fluksi i Lëndëve

Të gjitha prokuroritë themelore dhe prokuroria Speciale

Lloji i veprës penale: **Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës**

	Viti	Lëndë	
Lëndë të pazgjidhura më 1 Janar 2017 (PS)	2017	1177	
	2016	1424	
Lëndë të reja të hapura gjatë vitit kalendarik (I)	2017	622	
	2016	826	
Lëndë në Punë (LP)	2017	1799	
	2016	2250	
Lëndë të zgjidhura gjatë vitit kalendarik (R)	2017	843	
	2016	1073	
Lëndë të pazgjidhura më 31 dhjetor 2017	2017	956	
	2016	1177	

Norma e zgjidhjes së lëndëve

Norma e dëshiruar	100 %	
2017	135 %	
2016	130 %	

■ Regres ■ Progres

Norma e qarkullimit të lëndëve

Norma e dëshiruar	1.00	
2017	0.88	
2016	0.90	

■ Regres ■ Progres

Trendi i zgjidhjes së lëndëve

Year	Score	Rank
2017	5	100
2016	5	100

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve në ditë

2017	414	
2016	405	

Indeksi i lëndëve të grumbulluara

Vlera e dëshiruar	1.00	
2017	1.39	
2016	1.32	

■ Regres ■ Progres

Fluksi i lëndëve për periudhën 2016-2017 në të gjitha prokuroritë themelore dhe atë speciale

PS	I	LP	R	PE		VITI	
140	17	157	55	102	Speciale	2017	
184	40	224	84	140		2016	
610	301	911	426	485	Prishtinë	2017	
884	265	1149	539	610		2016	
45	74	119	56	63	Ferizaj	2017	
41	32	73	28	45		2016	
190	51	241	80	161	Mitrovicë	2017	
159	90	249	59	190		2016	
69	25	94	21	73	Prizren	2017	
60	80	140	71	69		2016	
48	80	128	81	47	Gjilan	2017	
17	198	215	167	48		2016	
35	44	79	56	23	Gjakovë	2017	
32	31	63	28	35		2016	
40	56	96	68	28	Pejë	2017	
47	90	137	97	40		2016	

Norma e zgjidhjes së lëndëve

Prokuroritë	Viti	%	
Speciale	2017	323 %	
	2016	210 %	
Prishtinë	2017	141 %	
	2016	203 %	
Ferizaj	2017	75 %	
	2016	87 %	
Mitrovicë	2017	156 %	
	2016	66 %	
Prizren	2017	84 %	
	2016	89 %	
Gjilan	2017	101 %	
	2016	84 %	
Gjakovë	2017	127 %	
	2016	90 %	
Pejë	2017	121 %	
	2016	108 %	

■ Regres ■ Progres


| Norma

Trendi i zgjidhjes së lëndëve


[illegible]

■ n/a

Norma e qarkullimit të lëndëve



Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve



Indeksi i lëndëve të grumbulluara

Prokuroritë	Viti	Indeksi
Speciale	2017	2.54
	2016	2.19
Prishtinë	2017	1.43
	2016	1.64
Ferizaj	2017	0.80
	2016	1.46
Mitrovicë	2017	2.37
	2016	2.69
Prizren	2017	3.28
	2016	0.84
Gjilan	2017	0.59
	2016	0.10
Gjakovë	2017	0.62
	2016	1.14
Pejë	2017	0.58
	2016	0.48

■ Regres ■ Progres

| Norma

Shtojca II. Statistika krahasuese për gjykatat 2016 - 2017

Niveli Qendror / Fluksi i Lendeve

Te gjitha Gjykatat Themelore

Lloji i veprës penale: **Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës**

	Viti	Lëndë	
Lëndë të pazgjidhura më 1 Janar 2017 (PS)	2017	355	
	2016	407	
Lëndë të reja të hapura gjatë vitit kalendarik (I)	2017	223	
	2016	232	
Lëndë në Punë (LP)	2017	578	
	2016	639	
Lëndë të zgjidhura gjatë vitit kalendarik (R)	2017	254	
	2016	284	
Lëndë të pazgjidhura më 31 dhjetor 2017	2017	324	
	2016	355	

Norma e zgjidhjes së lëndëve

Norma e dëshiruar	100 %	
2017	114 %	
2016	122 %	

■ Regres ■ Progres

Norma e qarkullimit të lëndëve

Norma e dëshiruar	1.00	
2017	0.78	
2016	0.80	

■ Regres ■ Progres

Trendi i zgjidhjes së lëndëve

2017	11	
2016	7	

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve në ditë















2017	468	
2016	439	

Indeksi i lëndëve të grumbulluara

Vlera e dëshiruar	1.00	
2017	1.40	
2018	1.32	

■ Regres ■ Progres

Fluksi i lëndëve për periudhën 2016-2017 në të gjitha gjykatat themelore


PS	I	LP	R	PE		VITI	
198	73	271	88	183	Prishtinë	2017	
193	81	274	76	198		2016	
18	19	37	27	10	Ferizaj	2017	
31	20	51	33	18		2016	
19	20	39	12	27	Mitrovicë	2017	
37	18	55	36	19		2016	
38	27	65	36	29	Prizren	2017	
31	26	57	19	38		2016	
48	37	85	38	44	Gjilan	2017	
57	41	98	50	48		2016	
12	17	29	16	13	Gjakovë	2017	
40	13	53	41	12		2016	
22	30	52	37	15	Pejë	2017	
18	33	51	29	22		2016	

| Norma


Trendi i zgjidhjes së lëndëve

■ n/a


Norma e qarkullimit të lëndëve



Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve



Indeksi i lëndëve të grumbulluara





Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

“Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) - i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”



FOL

FOL LEVIZJA

Andrea Gropa, No.35,
10000 Prishtinë
info@levizjafol.org
+38349131542